

Iniciativa për Progres (INPO),  
Instituti Demokratik i Kosovës (KDI),  
Instituti për Hulumtime Zhvillimore (RIINVEST),  
Klubi për Politikë të Jashtme (KPJ),  
Lëvizja FOL,  
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) dhe  
Nisma e të Rinjve për të Drejta të Njeriut (YIHR).

**RAPORTI I PROGRESIT**

# Made in Kosova

**2011**

Tetor 2011  
Prishtinë

Iniciativa për Progres (INPO),  
Instituti Demokratik i Kosovës (KDI),  
Instituti për Hulumtime Zhvillimore (RIINVEST),  
Klubi për Politikë të Jashtme (KPJ),  
Lëvizja FOL,  
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) dhe  
Nisma e të Rinjve për të Drejta të Njeriut (YIHR).

# RAPORTI I PROGRESIT

## Made in Kosova

### 2011

**Tetor 2011, Prishtinë**



“Ky botim është realizuar me përkrahjen e Friedrich Ebert Stiftung në Prishtinë. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e organizatave përkatëse të shoqërisë civile dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i fondacionit përkrahës, FES.”

## **Përmbajtje**

Përmbajtje	3
Shkurtesat dhe akronimet	4
Hyrje	5
<b>1. MARRËDHËNIET KOSOVË – RAJON – BE</b>	<b>6</b>
1.1 Kosova në raport me vendet e rajonit dhe integrimin evropian	6
1.2 Politika e jashtme	9
<b>2. PROGRESI POLITIK DHE INSTITUCIONAL</b>	<b>11</b>
2.1 Kuvendi i Republikës së Kosovës	11
2.2 Qeveria dhe sektori publik	13
2.3 Qeverisja lokale dhe procesi i decentralizimit	15
2.4 Menaxhimi i zgjedhjeve	20
2.5 Sundimi i ligjit dhe sistemi i drejtësisë	23
2.6 Prokurimi publik	26
2.7 Lufta kundër korrupsionit	28
2.8 Sektori i sigurisë	30
2.9 Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve	32
<b>3. PROGRESI EKONOMIK</b>	<b>37</b>
3.1 Sektori real	37
3.2 Sektori Fiskal	38
3.3 Sektori Financiar	39
3.4 Sektori i Jashtëm	40
3.5 Ambienti Biznesor	41
3.6 Privatizimi i Ndërmarrjeve Publike	42

## Shkurtesat dhe akronimet

**AKI** Agjensioni Kosovar për Inteligjencë  
**AKK** Agjensioni Kundër Korrupsionit  
**APP** Agjensioni i Prokurimit Publik  
**BE** Bashkimi Evropian  
**BPV** Bruto Produkti Vëndor  
**BQK** Banka Qendrore e Kosovës  
**CEFTA** Central Europea Free Trade Agreement  
**DK** Dogana e Kosovës  
**ENEMO** European Network of Election Monitoring Organizations  
**EULEX** European Union Rule of Law Mission  
**FMN** Fondi Monetar Ndërkombëtar  
**FSK** Forca e Sigurisë e Kosovës  
**IÇK** Indeksi i Çmimeve të Konsumit  
**ICO** International Civilian Office  
**IHD** Investimet e Huaja Direkte  
**IPOL** Instituti Ballkanik i Politikave IPOL  
**IPVQ** Institucionet e Përkohëshme të Vetëqeverisjes  
**KFOR** Kosova Forces  
**KQZ** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
**KRPP** Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik  
**KSK** Këshilli i Sigurisë së Kosovës  
**KZAP** Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
**MEF** Ministria e Ekonomisë dhe Financave  
**MMK** Monitorim, Mentorim dhe Këshillim  
**MPJ** Ministria e Punëve të Jashtme  
**MTPT** Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit  
**OJQ** Organizatë Joqeveritare  
**OKB** Organizata e Kombeve të Bashkuara  
**OSBE** Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë  
**OSHP** Organi Shqytrues i Prokurimit Publik  
**PK** Policia e Kosovës  
**QNR** Qendra e Numërimit të Rezultateve  
**RTK** Radio dhe Televizioni i Kosovës  
**SHIK** Shërbimi Informativ i Kosovës  
**TKPK** Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës  
**TVSH** Tatimi mbi Vlerën e Shtuar  
**UÇK** Ushtria Çlirimtare e Kosovës  
**UNMIK** United Nations Mission in Kosova

## HYRJE

Çdo vit, Komisioni Evropian publikon raportin e progresit për shtete kandidate apo kandidate potenciale të BE-së, që bën një përmbledhje të të arriturave dhe sfidave përkatëse për secilin shtet, si dhe të gjeturat kryesore të cilat përdoren si mekanizëm tejet i rëndësishëm në matjen dhe evaluimin e zhvillimeve në vend.

Vitin e kaluar në pritje të Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën, disa organizata të shoqërisë civile përgatitën versionin e parë kosovar të raportit të progresit i cili e reflektoi vlerësimin dhe pikëpamjen vendore mbi progresin në Kosovë. Qëllimi i këtij produkti, që ishte unik për shtetet që e marrin Raportin e Progresit nga Komisioni Evropian, ishte që të ofrohej një pasqyrë alternative ndaj progresit (ku hyjnë edhe stagnimi dhe regresi) në Kosovë, duke reflektuar pikëpamjen dhe vlerësimin e organizatave të shoqërisë civile kosovare mbi fushat esenciale të qeverisjes shtetërore.

Edhe këtë vit, organizatat e shoqërisë civile kanë përgatitur një raport të tillë. Ky raport vlerëson periudhën Tetor 2010 – Tetor 2011 dhe mbulon këto fusha:

- Marrëdhëniet Kosovë - rajon - BE
- Progresin politik dhe institucional (konsolidimi i institucioneve, zgjedhjet, sundimi i ligjit, qeverisja lokale, lufta kundër korrupsionit, të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve), dhe
- Progresin ekonomik (politikat ekonomike, tregtia e jashtme, sektori financiar).

Pasi që organizatat që kanë hartuar këtë raport janë të specializuara në fushat që i kanë mbuluar, një pjesë e materialit hulumtues reflekton punën monitoruese, hulumtuese, analitike dhe raportuese të tyre gjatë periudhës një-vjeçare. Për më tepër, vlerësimi mbështetet në shumë burime primare e sekondare dhe në konsultimet e zhvilluara me ekspertë të fushave përkatëse.

Organizatat që e kanë përpiluar “Raportin e Progresit Made in Kosova 2011” janë: Iniciativa për Progres (INPO), Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), Instituti për Hulumtime Zhvillimore (RIINVEST), Klubi për Politikë të Jashtme (KPJ), Lëvizja FOL, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) dhe Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (YIHR).

## 1. MARRËDHËNIET KOSOVË - RAJON - BE

### 1.1 Kosova në raport me vendet e rajonit dhe integrimin evropian

Deri para shpalljes së pavarësisë së Kosovës në shkurt 2008, Kosova në iniciativat rajonale merrte pjesë përmes UNMIK-ut si organizatë që administronte dhe prezantonte vendin jashtë me vendim të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Kështu Kosova edhe pse nuk njihej si shtet, ishte pjesë e iniciativave rajonale dhe ndërkombëtare. UNMIK-u kishte mundësuar anëtarësimin e Kosovës në iniciativën rajonale të tregtisë së lirë të njohur si CEFTA si dhe fillimin e integritit të vendit në BE përmes procesit të njohur atëherë si Mekanizmi Përcjellës i Stabilizim Asociimit.

Pas shpalljes së pavarësisë, pjesëmarrja e Kosovës në CEFTA u vështirësua për shkak të pengesave nga Serbia por edhe nga Bosnja që pengonin qarkullimin e lirë të mallrave të Kosovës ashtu siç parashihej edhe me marrëveshjen e CEFTA-s. Pengesë tjetër për pjesëmarrjen e Kosovës në iniciativat rajonale dhe integrimin në BE u paraqit edhe mosnjohja e Kosovës nga pesë vende anëtare të BE-së.

Me vendet fqinje Kosova ka kryesisht marrëdhënie konstruktive politike si dhe shkëmbim mallrash të lirë. Këto marrëdhënie mirëmbahen kryesisht për shkak të politikës së stabilitetit rajonal që udhëheq Kosova, që jo rrallë është mbajtur në kurriz të saj. Me Malin e Zi, Kosova akoma nuk e ka përfunduar procesin e demarkacionit të kufirit, proces i cili duket se nuk do të kalojë lehtë, dhe akoma nuk ka vendosur marrëdhënie diplomatike. Mali i Zi ka kërkuar njohjen e pakicës malazeze si kategori kushtetuese para se të shkëmbehen ambasadorët mes dy vendeve dhe të kryhet demarkacioni. Në kufi me këtë shtet fqinj, fshatarët e zonës së Rugovës janë ankuar se Mali i Zi ka shkelur zonën neutrale dhe ka penguar punën e tyre normale duke iu afruar territorit të Kosovës.

Gjatë vitit 2010 Kosova ka eksportuar mallra në Mal të Zi në vlerë prej 3,920,000.00 euro ose 1.3% të totalit të eksportit kosovar, ndërsa ka importuar 11,454,000.00 euro ose 0.5% e totalit të importit.<sup>1</sup>

Me Maqedoninë, Kosova, sikurse me Malin e Zi, ka marrëdhënie korrekte por me dallimin se me këtë shtet e ka të përfunduar demarkacionin si dhe ka vendosur marrëdhënie diplomatike. Mirëpo demarkacioni me këtë shtet Kosovës i ka kushtuar disa mijëra hektarë tokë sipas një marrëveshjeje ish-RFJ – Maqedoni të njohur edhe me pakon e Ahtisaarit.

Kosova importon një numër të lartë mallrash nga ky vend ku importi tejkalon shumëfish eksportin. Gjatë vitit 2010 Kosova ka eksportuar mallra në Maqedoni në vlerë prej 26,308,000.00 euro ose 8.9% e totalit të eksportit kosovar, ndërsa ka importuar në vlerë prej 319,313,000.00 euro ose 14.8% e totalit të importit.<sup>2</sup>

Nga vendet fqinje, marrëdhëniet më të mira Kosova i ka me Shqipërinë. Duke e konsideruar "shtet amë", zyrtarët kosovarë më së shpeshti e vizitojnë Shqipërinë dhe anasjelltas. Shqipëria ka qenë dhe vazhdon të jetë aktive në sigurimin e njohjeve për Kosovën dhe lobimin për përfshimin e Kosovës në iniciativa rajonale.

Marrëdhëniet tregtare nuk shënojnë ndonjë shkëmbim të lartë dhe ato kanë ecur po aq lehtë si marrëdhëniet politike dhe "vëllazërore" përveç një mosmarrëveshjeje rreth eksportit të patateve kosovare në Shqipëri gjatë vitit të kaluar. Sidoqoftë, Shqipëria është vendi ku Kosova eksporton më së shumti mallra nga të gjitha vendet e rajonit. Gjatë 2010-ës Kosova ka eksportuar në Shqipëri mallra në vlerë prej 30,841,000.00 euro ose 10.4% e totalit të eksportit kosovar, ndërsa ka importuar në vlerë prej 69,714,000.00 euro ose 3.2% e totalit të importit të Kosovës.<sup>3</sup>

1 Enti i Statistikave të Kosovës, Statistikat e tregtisë së jashtme 2010, Seria 3: Statistikat Ekonomike. [http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat\\_view/10-statistikat-ekonomike/14-statistikat-e-tregtise-se-jashtme](http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/10-statistikat-ekonomike/14-statistikat-e-tregtise-se-jashtme)

2 Ibid 1.

3 Ibid 1.

Në përgjithësi marrëdhëniet e Kosovës me vendet e rajonit, përveç me Serbinë, mbesin stabile. Kosova ka marrë kontrollin e kufijve me Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë dhe deri më tani nuk ka pasur incidente.

#### Veriu i Kosovës

Problemi kryesor i rrumbullakimit të shtetësisë së Kosovës mbetet shtrirja e sovranitetit të saj në tërë territorin e vet. Veriu i Kosovës është pika ku takohen Serbia dhe Kosova duke shënuar një lloj kufiri joformal por de facto. Ndërhyrja e 25 korrikut nga qeveria e Kosovës në veri të vendit shënoi tentativën e parë në këto 12 vitet e fundit për ta vendosur kufirin me Serbinë atje ku njihet dhe për ta shtrirë sovranitetin në tërë territorin e saj.

Nga të gjitha vendet e rajonit, vetëm me Serbinë Kosova nuk ka marrëdhënie politike për shkak që Serbia vazhdon të ketë pretendime territoriale ndaj Kosovës. Bile edhe marrëdhëniet ekonomike vazhdojnë të jenë asimetrike pasi që Serbia është eksportuesi më i madh në Kosovë dhe prej shpalljes së pavarësisë Kosova nuk arrinte të eksportonte në këtë vend. Ndërhyrja e 25 korrikut dhe negociatat e ashtuquajtura "teknike" në Bruksel sollën deri te një marrëveshje për vulat e doganave dhe shkëmbimi tregtar në kuadër të CEFTA-s ka rifilluar por jo pa probleme që po shkaktohen nga shteti serb. Gjatë vitit 2010 Kosova ka importuar nga Serbia mallra në vlerë prej 260,471,000.00 eurosh ose 12.1% e totalit të importit kosovar, ndërsa ka eksportuar pothuajse simbolikisht në raport me importin në vlerë 3,941,000.00 euro ose 1.3% e totalit të eksportit.<sup>4</sup>

Serbia vazhdon të ketë pretendime ndaj Kosovës duke shpallur edhe publikisht synimin e saj për marrjen e veriut të Kosovës. Ndarja është përjashtuar nga bashkësia ndërkombëtare, opSION ky që së fundi u tha qartë edhe nga kancelarja Merkel në vizitën e saj në Beograd në gusht të këtij viti. Negociatat në Bruksel nuk

duket se do të prodhojnë ndonjë zgjidhje afatgjate dhe gradualisht po duket se ato do të hyjnë në fazën e negociatave politike ku disa zyrtarë ndërkombëtarë në Kosovë kanë paralajmëruar se veriut do t'i jepet një "status autonom". Serbia duke luajtur një lojë të dyfishtë synon që përmes negociatave në Bruksel të sigurojë një vlerësim pozitiv nga Komisioni Evropian dhe ta fitojë statusin e vendit kandidat dhe në të njëjtën kohë ta mbajë veriun e Kosovës nën kontroll.

Qeveria e Kosovës me aksionin e 25 korrikut dështoi që t'i vërë nën kontroll dy pikat doganore si dhe ta shtrijë autoritetin e saj në veri të vendit. Si rezultat i kësaj mund të pritët futja e veriut në tavolinën e bisedimeve Kosovë - Serbi që mund të rezultojnë me autonomi për veriun.

Sidoqoftë, nuk duket se do të ketë zgjidhje të shpejt të problemeve mes dy vendeve. Ato do të vazhdojnë përderisa nuk ka një rol më aktiv dhe lidhës nga perëndimi që do të detyronte Serbinë ta pranonte realitetin në Kosovë pa kushte dhe do ta bënte të qartë rrugën e integritit të dy vendeve në BE dhe NATO.

#### Marrëdhëniet me BE-në

Kosova është pjesë e Proces Stabilizim-Asociimit (SAP), mirëpo ende vazhdon të mbetet i vetmi shtet në rajon që nuk ka marrëdhënie kontraktuale me BE-në. Kjo e pamundëson Kosovën të ndërmarrë një varg reformash e të jetë pjesë e shumë proceseve integruese në hap me rajonin mbase nuk mund të nënshkruhen Marrëveshje të Stabilizim-Asociimit (SAA).

Në kuadër të SAP Dialogut për Kosovën, parashihen që të mbahen tetë takime sektoriale dhe një plenare (shumica e fushave sektoriale trajtohen në këtë raport), dhe po ashtu dialogun me shoqëri civile dhe Komiteti i Përbashkët për Monitorim. Edhe këtë vit janë mbajtur cikli i takimeve në kuadër të Procesit të Stabilizim-Asociimit (SAPD), të përcjellura me takimin plenar më 1 korrik ndërmjet Komisionit Evropian dhe institucioneve kosovare. Përderisa vlerësimet finale publikohen si pjesë e

<sup>4</sup> Ibid

raportit të progresit të Komisionit Evropian në tetor 2011, në takim u ritheksua nga aktet e të dy palëve që fushat që kanë nevojë për më shumë reforma janë sundimi i ligjit dhe lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, administrata publike, reforma elektorale dhe kushtetuese dhe politikat makro-ekonomike (që shtjellohen në hollësi në këtë raport në vijim). Këto fusha, e me veçanti sundimi i ligjit, lufta kundër korrupsionit, qeverisja e mirë dhe reforma e administratës publike për më tepër ndikojnë edhe në inicimin e dialogut për liberalizimin e vizave për Kosovën.

Mirëpo dy vjet pas publikimit të Studimit për Kosovën (2009) nga KE, që hapi dy rrugë për Kosovën - fillimi i dialogut të vizave me perspektivë të liberalizimit eventual pasi të jenë përmbushur reformat e nevojshme dhe krijimi i marrëveshjes së tregtisë ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës - Kosova ende vazhdon të mbetet jashtë këtyre proceseve. Plani i qeverisë së Kosovës që t'i paraprinte nismës së dialogut nëpërmjet hartimit dhe implementimit të udhërrëfyesit unilateral dhe të ngjashëm me atë zyrtar të KE-së për vendet e rajonit nuk e përshpejtoi procesin. Në fakt, gati dy vjet pasi që vendeve të Ballkanit Perëndimor iu hoq regjimi i vizave, Kosova vazhdon të mbetet pa një proces të filluar. Institucionet relevante ndërmorrën hapa në përmbushjen e parakushteve të caktuara nga KE, si në adaptimin e legjislacionit për riatdhesim. Mirëpo misionet teknike të KE-së vazhdimisht vlerësuan që ende mbetej të shënohet progres në krijimin e kushteve në terrren në komuna për riatdhesim dhe riintegrim.

Gjatë muajit shtator të këtij viti, misioni teknik i KE-së sërish vizitoi institucionet relevante, dhe rezultatet priten të dalin gjatë muajit tetor. Sido që të jetë, implementimi më i shpejt dhe efikas nga ana e institucioneve të Kosovës në çështjet kryesore të udhërrëfyesit, përfshi sigurinë e dokumenteve personale, migracionin ilegal, rendin dhe sigurinë publike dhe marrëdhëniet e jashtme dhe të drejtat themelore, kanë mundur të përdoren më

shumë si mjet për shtytjen dhe zhvillimin e reformave. Vlerësimet dhe konkludimet e vizitës së fundit të misionit teknik priten të përcaktojnë marrjen apo jo të udhërrëfyesit zyrtar.

Përsa i përket zgjedhjeve nacionale të 12 dhjetorit, 2010, në Kosovë ishin prezent ekipet monitoruese të Parlamentit Evropian dhe European Network of Election Monitoring Organisations. Në përgjithësi, ekipet monitoruese evidentuan që ka pasur shkelje të procedurave dhe manipulime, por që dita e zgjedhjeve ishte mirë e organizuar dhe që pjesëmarrja e mirë është inkurajuese për vazhdimin e zhvillimit demokratik të Kosovës, ku theks të veçant iu dha edhe pjesëmarrjes së rritur të komunitetit serb në zgjedhje. Megjithatë, kritika në vend, posaçërisht nga shoqëria civile, ishte që pritet ishin më të mëdha nga këto ekipe në ndëshkimin e parregullsive të evidentuara, posaçërisht duke marrë parasysh që vlerësimet e këtyre ekipeve do mund të bartnin edhe peshë më të rëndësishme.

Gjatë vitit të fundit, roli më i dukshëm i BE-së ka qenë në raport me bisedimet teknike Prishtinë-Beograd, që janë mbajtur nën ombrellën e BE-së. Bisedimet filluan më 8 mars, 2011 me qëllim që të fokusohen në bashkëpunimin regjional, lirinë e lëvizjes dhe sundimin e ligjit. Deri më tani janë mbajtur gjashtë raunde të bisedimeve, ku është vendosur për regjistra civilë dhe vula. Raundi i shtatë është paraparë më 28 shtator, por u bojkutuan nga pala serbe mbase BE dhe SHBA nuk pranuan propozimin e Serbisë që çështja e Veriut të jetë pjesë e diskutimve.

Shumica e çështjeve për diskutim kanë implikime më të mëdha si dhe ndikim për qytetarët e Kosovës - si për shembull fakti që Serbia bllokoi tregtinë e Kosovës, ndalohej përdorimi i hapësirës ajrore mbi Serbi për fluturime, nuk lejoi pasagjerë me pasaporta apo regjistrim të makinave të Kosovës, dhe si Kosova nuk mund të ketë prefiks në vet apo të anëtarësohet në shumë organe ekonomike ndërkombëtare për shkak të kundërshtimit të Beogradit etj. Edhe pse zgjidhja e çështjeve të tilla



mund të përmirësojë përditshmërinë e jetës së qytetarëve të Kosovës, në një kontekst politik, Kosova dhe Serbia hyjnë në bisedime nga pozicione të ndryshme dhe sidomos sa i përket faktit që bisedimet thuhet se do të përcaktojnë rrugën e Serbisë dhe Kosovës drejt anëtarësisë në BE. Ndërsa nga njëra anë Serbia tashmë po kalon nëpër Marrëveshjen e Stabilizimit Asociimit dhe rruga e saj drejt arritjes së statusit të shtetit anëtar është hapur, nga ana tjetër Kosova nuk ka madje as kapacitetet për të hyrë në marrëveshje kontraktuale me BE-në. Kështu, Kosova ka mbetur shumë prapa në kanalet e proceseve zyrtare për integrimin në BE, sidomos në krahasim me të gjithë rajonin. Prandaj, bisedimet mund të përfundojnë me sjelljen e zgjidhjeve për çështje që kryesisht janë bllokuar apo penguar nga Serbia deri më tani, ndërkohë që Kosova jo detyrimisht fiton shumë sa i përket avancimit politik.

BE është prezente me Kosovë nëpërmjet misionit European Security and Defence Policy (ESDP) në fushën e sundimit të ligjit, nëpërmjet Përfaqësuesit Special si dhe kontribuimit në Zyrën Civile Ndërkombëtare (ICO). Gjatë vitit 2011, për Kosovën janë parashikur € 68.7 milionë të ndihmës financiare në kuadër të **Instrument for Pre-Accession Assistance (IPA)**.

Ndërkohë, BE-ja ka në Kosovë edhe Misionin e Sundimit të Ligjit, EULEX. Përderisa efikasiteti i punës së këtij misioni trajtohet në pikën e sundimit të ligjit, perceptimi publik vazhdon të mbetet se EULEX-i dhe qeveria e Kosovës janë në mosmarrëveshje rreth çështjeve të nxehta, si korrupsioni i nivelit të lartë. Kjo ndikon në uljen e besimit të publikut në aftësinë e EULEX-it për të luftuar korrupsionin dhe gjithashtu rrezikon të forcojë edhe më tej ndjenjën e mosndëshkimit të fortëve në Kosovë.

#### Marrevëshja e tregtisë me BE-në

Në fillim të vitit 2011, Kosovës i janë hequr Masat Preferenciale Tregtare që i ka patur për 10 vjet me vendet e Bashkimit Europian. Këtë preferencë vendet e tjera

të Ballkanit Perëndimor e kanë të mbuluar nëpërmjet marrëveshjeve kontraktuale me BE-në, si pjesë të SAA. Përderisa nuk dihet se a është arsyeja kryesore neglizhenca e institucioneve të Kosovës për të ripërtërirë këto masa, apo mosmarrëveshja në mes të shteteve anëtare të BE-së për qasje ndaj Kosovës, ky hap është edhe një më shumë që largoi Kosovën nga proceset integruuese Europiane.

## **1.2 Politika e jashtme**

### Lobimi dhe shumëfishimi i posteve zyrtare

Numri i posteve politike në qeveritë e njëpasnjëshme të Kosovës ka shkuar gjithnjë duke u rritur. Zakonisht kjo është bërë më shumë për akomodim të individëve në pozita qeveritare sesa nga nevoja për një post të fillë. Ky trend ka vazhduar edhe me qeverinë e koalicionit PDK – KKR.

Politika e jashtme e Kosovës udhëhiqet nga Presidenca dhe nga Ministria e Punëve të Jashtme. Mirëpo qeveria vendosi ta shumëfishojë politikën e jashtme për hir të aleatit të saj. Pas rrëzimit të Behxhet Pacollit nga pozita e presidentit me vendim të Gjykatës Kushtetuese, ai u rrimërua nga kryeministri Thaçi në postin e zëvendëskryeministrit të parë por që në portofol do t'i kishte punët e jashtme, më saktësisht lobimin dhe sjelljen e njohjeve të reja. Pacolli u emërua në këtë post paçka se qeveria e Kosovës tashmë kishte një ministër të punëve të jashtme, Enver Hoxhaj dhe dy zëvendësministra të jashtëm, si dhe një zëvendëskryeministre për dialogun, Edita Tahirin, sferë që bie në fushën e politikës së jashtme. Kjo në pamje të parë nuk u duk ndonjë shumëfishim postesh pasi që Pacolli ishte përqendruar në shtetet e Afrikës dhe Amerikës Qendrore. Deri te çarja apo te rivaliteti mes këtyre dy zyrtarëve qeveritarë erdhi kur filloi gara për të përvetësuar meritat për njohjet. Sot Pacolli pretendonte se kishte sjellë një njohje të re, të nesërmen paraqitej Hoxhaj me pretendimin se edhe ai kishte sjellë një njohje tjetër.

Kjo para së gjithash ishte një luftë

mediatike rreth asaj se kush ishte më meritori për njohjet e reja. Ky rivalitet fryhej edhe më shumë nga fakti se dy zyrtarët qeveritarë vinin nga parti të ndryshme të koalicionit dhe sipas të gjitha gjasave ndjeheshin të rrezikuar nga njëri-tjetri. Në frymën e kësaj jepet edhe përshtypja se edhe deklaramet për njohjet e fundit që kanë ardhur për Kosovën por pa prezantuar letrat e njohjes janë bërë me nguti vetëm sa për të marrë sa më parë meritat për njohjet e reja. Disa shtete sipas këtyre dy zyrtarëve kishin njohur Kosovën por asnjëri nuk kishin prezantuar letrat e njohjeve nga këto shtete. Kjo ngrite dyshime dhe krijonte dilema rreth njohjeve por edhe linte shijen e keqe të garës mes zyrtarëve qeveritarë për të marrë meritat e njohjeve në vend të sjelljes së njohjeve të reja për çka edhe janë mandatuar.

#### Njohjet e reja

Një konfuzion rreth njohjeve u krijua pas shkrimeve në një gazetë serbe se Sulltanati i Omanit dhe Guinea Bissau nuk e kishin njohur Kosovën. Pas kësaj zhurme u sqarua se Guinea Bissau e kishte njohur Kosovën por Sulltanati i Omanit nuk kishte dërguar njohje verbale përveç një letre ku i referohej Kosovës si "Republika e Kosovës". Omani disa ditë më vonë konfirmoi njohjen duke ngritur në 81 numrin e njohjeve me gjithë njohjet e fundit që erdhën nga Shën Luçia dhe disa shtete tjera.

Zëvendëskryeministri Pacolli ka ditë që ka lajmëruar për njohje nga Gaboni mirëpo Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ) akoma nuk e ka renditur në uebfaqen e saj si njohje të 82-të. Pacolli ka deklaruar se bashkë me Gabonin, Kosovën e kanë njohur edhe Nigeria dhe Bregu i Fildishtë. Mosndryshimin e numrit të njohjeve nga 81 në 84 nga MPJ, Pacolli e ka quajtur, me ironi, gabim dhe harresë të MPJ-së.<sup>5</sup> Mirëpo MPJ nuk i ka renditur si njohje për shkak se akoma nuk i kanë pranuar notat verbale të njohjes nga këto shtete duke pranuar

se megjithatë këto shtete e kanë njohur Kosovën.

#### Pesëshja e BE-së

Çështje problematike për Kosovën po tregohet mosnjohja e saj nga pesë vende anëtare të BE-së. Kjo deri më tash ka penguar vendosjen e marrëdhënieve kontraktuale me BE-në çfarë do t'i hapte rrugë nënshkrimit të marrëveshjeve dhe do ta përshpejtonte integrimin e Kosovës në BE. Kosovës në marrëdhëniet e saj me BE-në mbase do t'i duhet të improvizojë në disa fusha si p.sh. liberalizimin e vizave dhe marrëdhëniet tregtare me BE-në ku për shkak të mosnjohjes nga këto pesë shtete, në vend të hyrjes në marrëdhënie kontraktuale dypalëshe Kosovë-BE, ajo do të duhet të hyjë në marrëdhënie kontraktuale 27-palëshe. Prandaj, për të shmangur situata absurde dhe të mundimshme, Kosovës i duhet që sa më parë të vendosë marrëdhënie me këto shtete, nëse jo njohje të paktën të vendosë komunikim të rregullt në mënyrë që ato mos ta pengojnë Kosovën në rrugën e saj drejt BE-së si dhe qasjen e saj në iniciativat rajonale.

#### Marrëveshja e prishur

Imazhi i Kosovës në skenën ndërkombëtare u rrënuar edhe me tej me prishjen e marrëveshjes ndërmjet Kosovës me FMN-në, që erdhi si pasojë e rritjes së pagave, që ishte në kundërshtim me objektivat e programit të Stand by Agreement ne FMN.<sup>6</sup> Prishja e kësaj marrëveshje jo vetëm që i shkaktoi Kosovës humbje të granteve prej 150 milion Euro dhe kredive të buta koncesionare prej 100 milion Euro (ku ishin të përfshira edhe përkrahjet buxhetor nga Komisioni European si dhe Banka Botërore), por po ashtu dërguan Kosovën një hap mbrapa në marrëdhëniet e saj me FMN-në, që ishte një ndër organizatat e vetme ndërkombëtare ku Kosova kishte arritur të anëtarësohej.

<sup>5</sup> Indeks Online, "Jahjaga e Thaçi për njohjet: I besojnë Pacolli, jo Hoxhaj", 25 shtator, 2011  
<http://www.indeksonline.net/?page=1,2,8517>

<sup>6</sup> "Kosovo, IMF end agreement." SE Times. [http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en\\_GB/features/setimes/roundup/2011/06/03/roundup-bs-05](http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/roundup/2011/06/03/roundup-bs-05)

## 2. PROGRESI POLITIK DHE INSTITUCIONAL

### 2.1 Kuvendi i Republikës së Kosovës

Mandati i Legjislaturës së tretë të Kuvendit të Republikës së Kosovës përfundoi një vit para kohe me 2 nëntor 2010. Kjo erdhi si rezultat i votimit të suksesshëm të mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë të ngritur nga grupi parlamentar i AKR-së. Mocioni u përkrah nga 40 deputetë të Kuvendit të Kosovës, si dhe dekretit të mëpastajshëm të ushtruesit të detyrës së Presidentit të Republikës Jakup Krasniqi që të shpërndajë Kuvendin e Kosovës.

Legjislatura e IV-të e Kuvendit të Republikës së Kosovës, doli si rezultat i zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 12 dhjetorit 2010, zgjedhje të cilat u vlerësuan si nga faktorët vendorë ashtu edhe ata ndërkombëtarë si mjaft të kontestueshme për shkak të parregullsive të mëdha. Kjo legjislaturë, qysh në fillim të mandatit është ballafaquar me një proces të ndërlikuar me rastin e zgjedhjes së Presidentit të Republikës së Kosovës. Jo më shumë se 35 ditë nga zgjedhja e z. Behgjet Pacollit (AKR), President i Republikës së Kosovës, Gjykata Kushtetuese e rrëzoi atë, duke e konsideruar mënyrën e zgjedhjes së tij nga ana e Kuvendit si antikushtetuese. Vendimi u morr pas ngritjes së kësaj çështjeje nga deputetët e LDK-së dhe AAK-së<sup>7</sup>.

Më 7 prill, 2011 Kuvendi zgjodhi Presidentin e ri të Kosovës. Ish-zëvendësdrojtresha e përgjithshme e Policisë së Kosovës, Atife Jahjaga qysh në raundin e parë mori shumicën e votave nga parlamentarët e pranishëm në sallë. Presidentja Jahjaga u zgjedh pas marrëveshjes paraprake të arritur ndërmjet tri partive politike: PDK-së, LDK-së dhe AKR-së.

Çështje tjetër me rëndësi që e ka përcjellë këtë legjislaturë të Kuvendit të Kosovës është dialogu Kosovë-Serbi.

Kuvendi pothuajse i fundit i ka parë marrëveshjet (konkluzat) e arritura në këto bisedime dhe ka patur shumë pak informata lidhur me mbarëvajtjen e këtij procesi.

Në përgjithësi, Qeveria ka injoruar rolin e Kuvendit në këtë proces.

Çështjet tjera që e kanë karakterizuar punën e Kuvendit të Kosovës gjatë kësaj periudhe janë: mosgatishmëria e kabinetit qeveritar për të qenë të pranishëm në seanca plenare kur trajtoheshin çështjet me rëndësi si Raporti i shpenzimeve për Buxhetin e Kosovës për vitin 2010, Raporti vjetor i Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK) për vitin 2010; mos gatishmëria e deputetëve të qëndrojnë në seanca plenare, votimi i deputetëve për kolegjet e tyre, fillimi i trajtimit të çështjeve dhe mos-përfundimi i tyre (rasti i debatit për SHIK-un) etj.

#### Mbikëqyrja parlamentare ndaj Qeverisë

Struktura e tanishme politike e Kuvendit, ka ndryshuar pozitivisht rolin mbikëqyrës të qeverisë nga ana e Kuvendit të Kosovës në krahasim me strukturën e kaluar. Edhe pse edhe gjendja e tanishme nuk është e kënaqshme, megjithatë dallimi në numrat e deputetëve që janë pjesë e koalicionit qeverisës dhe subjekteve politike opozitare, ka bërë që të ketë një pozitë dhe opozitë mjaft të konsoliduar. Kjo ka ndikuar dukshëm në dinamizmin e punës së Kuvendit të Kosovës dhe është rritur roli mbikëqyrës i Kuvendit ndaj qeverisë së Kosovës, me theks të veçantë përmes instrumentit demokratik të kontrollit parlamentar-interpelancave parlamentare. Megjithatë kjo nuk ka ndodhur edhe përmes instrumentit tjetër të kontrollit parlamentar, përmes pyetjeve parlamentare. Numri shumë i vogël i pyetjeve parlamentare të parashtruara nga deputetët e kësaj legjislature si dhe injorimi i tyre nga kabineti qeveritar, nuk janë shembulli i mirë i kontrollit dhe balancimit mes pushteteve.

#### Interpelancat

Shfrytëzimi i interpelancave ka shënuar rritje nga legjislaturat e kaluara. Vetëm për periudhën pesë mujore, janë organizuar dy

<sup>7</sup> <http://www.kuvendikosoves.org> Rregullorja për Rendin dhe Qasjen e Mediave dhe Publikut në Punën e Kuvendit të Kosovës.

interpelanca parlamentare. Që të dyja janë bërë me kërkesë të Lëvizjes Vetëvendosje ku i ftuar në të dy rastet ishte Kryeministri i Kosovës z. Hashim Thaçi. Interpelanca e parë ishte organizuar në seancën e 5 majit 2011, lidhur me bisedimet Kosovë- Serbi, ndërsa interpelanca e dytë ishte organizuar me 30 qershor 2011 lidhur me autostradën Vërmicë - Merdare.

#### Pyetjet parlamentare

Në periudhën shkurt-qershor 2011, deputetët kanë parashtruar gjithsej 36 pyetje parlamentare për kabinetin qeveritar. Në përgjithësi, numri më i madh i pyetjeve të deputetëve janë parashtruar nga deputetë të partive opozitare. Ndërkohë, vetëm tre deputetë nga subjektet politike në pushtet nga pozita kanë parashtruar gjithsej tetë pyetje parlamentare. Krahasuar me periudhat e kaluara, trendi i parashtrimit të pyetjeve parlamentare ka pësuar një rënie të ndjeshme.

#### Implementimi i Planit Legjislativ të Kuvendit për vitin 2011

Kuvendi i Kosovës në prill të këtij viti ka miratuar planin e punës duke u bazuar në Strategjinë Legjislative të Qeverisë së Kosovës. Ky plan parashihte që gjatë vitit 2011 të miratohen në të dy leximet 148 projektligje dhe 15 akte të tjera.

Miratimi i shumë projektligjeve me procedurë të përsheptuar, duke iu shmangur Rregullores së Punës së Kuvendit, në vazhdimësi po derivon legjislacion me kualitet të dobët dhe pothuajse të pazbatueshëm në praktikë. Fakti që në Strategjinë Legjislative të Qeverisë për vitin 2011, rreth 60 % të ligjeve janë për plotësim ndryshim, tregon për qasjen e institucioneve në procesin ligjvënës si dhe cilësinë e ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës.

Qeveria e Kosovës nuk i ka proceduar me kohë të gjitha projektligjet ashtu siç është paraparë me Strategjinë e saj Legjislative, dhe Kuvendi është përballur me këtë çështje vit pas viti. Andaj, Kuvendi duhet të fuqizojë rolin e vet në procesin e hartimit

të Legjislacionit në të gjitha fazat dhe jo të shndërrohet në një organ i cili vetëm i voton aktet legjislative.

#### Transparenca e Kuvendit

Kuvendi i Kosovës nuk ka transparencë të mjaftueshme. Në vend që të ndërmerren veprime të cilat do të avancojnë transparencën, Kuvendi po nxjerrë rregullore që edhe më tutje e pengon transparencën e tij. Fakti shqetësues është Rregullorja për Rendin dhe Qasjen e Mediave dhe Publikut në Punën e Kuvendit të Kosovës, e miratuar nga Kryesia e Kuvendit me 19 prill 2011. Kjo Rregullore ndalon fotografimin dhe video-incizimet nga holli i Kuvendit të Kosovës - "Nuk lejohet fotografimi dhe video-incizimet nga holli i Kuvendit"<sup>8</sup> thuhet në mënyrë taksative në këtë pikë. Një qasje e tillë tregon për tendencën regresive të Kuvendit në transparencën e këtij institucioni.

Mbledhjet e Kryesisë së Kuvendit vazhdojnë të mbahen të mbyllura për organizatat e shoqërisë civile dhe publikun, ndërkohë që mbeten të hapura vetëm për organizatat ndërkombëtare të cilat veprojnë në Kosovë siç janë OSBE, NDI dhe ICO.<sup>9</sup> Transmetimi i seancave plenare nga RTK (televizioni publik) vetëm deri në orën 17, si dhe vështirësitë në qasje në dokumentet publike janë të metat tjera që po e cenojnë transparencën e këtij institucioni.

#### Përfshirja e qytetarëve në konsultimet publike - Dëgjimet Publike

Dëgjimet publike, si mekanizëm i Kuvendit, u mundësojnë deputetëve të marrin informata dhe ekspertizë nga grupet e shoqërisë civile, organizatave sektoriale, grupeve të caktuara të interesit apo edhe vetë qytetarët lidhur me projektligjet të cilat janë në hartim. Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur vetëm tre dëgjime publike, dhe atë vetëm në muajin qershor. Kërkesa e OSHC-ve (Organizatave të Shoqërisë Civile) në vazhdimësi ka qenë që numri i konsultimeve të rritet. Në krahasim me legjislaturën e

8 <http://www.kdi-kosova.org>. Raporti mujor i monitorimit të punës së Kuvendit të Kosovës, qershor 2011.

9 <http://www.kdi-kosova.org>. Administrata e Kuvendit në relacion me vërejtjet e Raportit të Progresit (2010).

kaluar ku vetëm gjatë sesionit pranveror janë organizuar rreth 17 dëgjime publike, gjatë periudhës raportuese është shënuar rënie në numrin e konsultimeve publike.

#### Monitorimi i Zbatimit të Ligjeve

Implementimi i ligjeve mbetet sfidë. Sipas detyrave të përcaktuara me Rregulloren e Punës, Komisionet parlamentare kanë edhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve. Mirëpo, deri në fund të muajit gusht, në përjashtim të një komisioni, (Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri) asnjë komision tjetër nuk ka arritur të përmbyll këtë proces dhe seancës t'i paraqes raportin me rekomandime nga ky monitorim, edhe pse shumica e komisioneve në planet e tyre të punës kanë paraparë monitorimin e një apo dy ligjeve që dalin nga fushëveprimtaria e tyre. Në krahasim me gjashtë mujorin e legjislaturës së kaluar, planifikimet duket se janë më progresive. Megjithatë, është dukshëm larg nevojave që Kuvendi të marrë rol më domethënës në kontrollin e zbatimit të ligjeve nga institucionet kompetente.

#### Administrata e Kuvendit të Kosovës

Puna e një legjislature varet në masë të madhe nga një administratë profesionale dhe e pavarur nga ndikimet politike. Praktika në Kuvendin e Kosovës po tregon se ekziston një ndikim shumë i madh i politikës në punën e Administratës së Kuvendit, qoftë në rekrutimin e stafit, qoftë në çështjet tjera organizative. Ndikimi i politikës në rekrutimin e stafit të administratës së Kuvendit ka ndikuar negativisht në punën ekipore, bashkëpunimin mes njësive organizative, dhe marrëdhëniet kolegjiale. Rekrutimi i stafit përmes porosive nga qarqet politike, duke injoruar meritokracinë bazuar në përgatitjet profesionale, i kanë dërguar sinjal edhe Komisionit Evropian për t'i adresuar ato përmes Raportit të Progresit për Kosovën për vitin 2010.<sup>10</sup> Shqetësim në

<sup>10</sup> <http://www.kdi-kosova.org>. Administrata e Kuvendit në relacion me vërejtjet e Raportit të Progresit (2010).

lidhje me administratën e Kuvendit po ashtu mbetet jo vetëm tendenca e ndikimit në punën e administratës civile nga qarqet të ndryshme politike, por madje edhe nga vetë deputetët e caktuar individualisht.<sup>11</sup>

## **2.2 Qeveria dhe sektori publik**

### Konteksti politik

Deri në shkurt të vitit 2011, Kosova drejtohej nga një Qeveri në dorëheqje. Shpërbërja e Qeverisë ndodhi pas shpalljes së tërheqjes nga koalicioni qeverisës i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK-së). Lideri partiak i LDK-së, z. Fatmir Sejdiu, ishte President i Kosovës deri në dorëheqjen e tij të 27 shtatorit, (ku si rezultat i vendimit të Gjykatës Kushtetuese ai nuk mund të mbante dy poste njëkohësisht, atë të liderit të partisë dhe të Presidentit). Zgjedhjet e parakohshme ishin caktuar për 12 dhjetor. Ndërsa, shumë parregullsi, të cilat kishin ndodhur gjatë procesit të votimit, kanë shtruar rrugën për përsëritjen e zgjedhjeve në pesë komuna.<sup>12</sup>

Në përgjithësi, Qeveria e Kosovës, ndonëse me resurse të kufizuara njerëzore, teknike dhe financiare, vazhdon të prodhojë rezultate më të ulëta, se sa që janë pritjet. Mungesa e resurseve, kryesisht mbulohet përmes asistencës ndërkombëtare, e cila në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikon në pavarësinë e ekzekutivit. Kuvendi i Kosovës nuk e ushtron si duhet funksionin e vetmbikëqyrës ndaj Qeverisë, duke i lënë kësaj të fundit, duart e lira në shumë sfera të rëndësishme të politikave. Në praktikë, niveli i transparencës së Qeverisë, karakterizohet si i pamjaftueshëm, por edhe jo proporcional me retorikën e fuqishme të Qeverisë për transparencë. Mekanizmat e llogaridhënies dhe të integritetit, nuk janë të zhvilluara sa duhet dhe për më tepër nuk zbatohen në mënyrë efektive as në nivelin praktik.<sup>13</sup>

<sup>11</sup> Këto të dhëna dalin nga informatat që KDI i ka siguruar nga monitorimi i përditshëm i Kuvendit të Kosovës dhe nga intervistimi i personave përgjegjës.

<sup>12</sup> Më shumë mbi zgjedhjet, në pikën e "Menaxhimit të Zgjedhjeve"

<sup>13</sup> KDI & TIK, Studimi i Integritetit të Sistemit Institucional 2011, Gusht 2011

### Ligj për Qeverinë

Funksionimi i Qeverisë së Kosovës ka nevojë urgjente për rregullim ligjor. Projektligji për Qeverinë, i është dërguar Kuvendit të Kosovës për miratim në maj të vitit 2009, ndërsa vetëm disa ditë para publikimit të këtij raporti, ka kaluar leximin e parë në Kuvend.<sup>14</sup> Në periudhën janar 2008 – qershor 2011, Qeveria e Kosovës ka miratuar dhe proceduar për në Kuvend 252 projektligje. Shumica e këtyre projektligjeve janë shndërruar në ligje pas miratimit në Kuvend. Por, në mesin e këtyre ligjeve nuk ndodhej edhe projektligji për Qeverinë e Kosovës. Ekzekutivi i vendit edhe gjatë periudhës raportuese ka vazhduar të funksionojë pa një ligj të veçantë. Formalisht, baza ligjore e cila rregullon funksionet e degës ekzekutive është Rregullorja e UNMIK-ut 2001/19 mbi degën ekzekutive të institucioneve vetëqeverisëse.<sup>15</sup> Mos ekzistenca e një ligji për Qeverinë dhe kufizimi i rolit të Kuvendit të Kosovës për të përcaktuar strukturën e Qeverisë, të cilin ai e zgjedh, ka bërë që struktura qeveritare të rritet pambarimisht, duke mos pasur një bazë ligjore që vendos rregullat e krijimit dhe shuarjes së portofolave ministrore.<sup>16</sup>

Shoqëria civile në Kosovë ka qenë proaktive në ngritjen e çështjes së ligjit për qeveri dhe ka ofruar rekomandime të shumta për përmbajtjen e një ligji të këtillë. Është rekomanduar që pjesë të Rregullores 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive të përfshihen në këtë draft të Ligjit për Qeverinë. Por, për tu përmbushur obligimi kushtetues se Qeveria i nënshtrohet kontrollit parlamentar, nevojitet që baza ligjore për funksionimin e Qeveritë të rregullohet me ligj të Kuvendit të Kosovës. Disa nga zbrazëtitat ligjore që duhet të plotësohen me Ligjin për Qeverinë janë: Numri i portofolave ministrore, shtimi dhe

<sup>14</sup> Gazeta Express, Miratohen në parim projektligji për qeverinë, në <http://www.gazetaexpress.com/?cid=1,13,63333>, 22 shtator 2011

<sup>15</sup> Rregulloren mund ta gjeni në [http://www.unmikonline.org/albanian/regulations/2001/RA2001\\_19.pdf](http://www.unmikonline.org/albanian/regulations/2001/RA2001_19.pdf)

<sup>16</sup> Instituti GAP, Nevoja për Miratimin e Ligjit për Qeverinë, Gusht 2011

shuarja e posteve, Detyrat dhe përgjegjësitë e Qeverisë në dorëheqje dhe Përgjegjësia e anëtarëve të Qeverisë ndaj Kuvendit të Kosovës.<sup>17</sup>

### Ristrukturimi i kabinetit

Në shkurt 2011, u shua Ministria e Energjisë dhe Minierave, nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave u krijuan dy ministri, Ministra e Financave dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, si dhe përbërja e re qeveritare rriti postin e zëvendëskryeministrave nga 2 në 6. Të gjitha këto ndryshime në strukturën e Qeverisë së Kosovës u bënë pa asnjë vendim ekzekutiv apo ligjor. Kurse, në maj të 2011, Qeveria e Kosovës me vendim ekzekutiv themeloi edhe ministrinë e 19 me radhë – Ministrinë e Diasporës.

### Çështjet e nxehta

Gjatë periudhës raportuese, qeveria e Kosovës është ballafaquar me disa zhvillime të nxehta politike, të cilat kanë konsumuar pjesën më të madhe të energjisë së ekzekutivit. Ndër këto zhvillime, veriu i Kosovës dhe situata e sigurisë në këtë pjesë, si dhe bisedimet me Serbinë, kanë dominuar agjendën dhe rrjedhimisht kanë zvogëluar aftësinë performuese të qeverisë së Kosovës.

Në përgjithësi, qeveria e Kosovës ka treguar performansë jo të kënaqshme në përmbushjen e detyrave të veta, e sidomos në raport me implementimin e agjendës për integritet evropiane.

### Sektori publik

Sektori publik, sikur në vitet e kaluara, edhe gjatë periudhës raportuese të këtij raporti ka vazhduar të mbetet i politizuar dhe i ndjeshëm ndaj ndikimeve të drejtpërdrejta të Qeverisë, sidomos në rastet e emërimeve të larta publike. Burimet e sektorit publik në Kosovë janë jashtëzakonisht të kufizuara, me paga shumë të ulëta dhe me përfitime, po ashtu, të pakta. Është një administratë

<sup>17</sup> Ibid 16.

e stërngarkuar dhe e politizuar, një shqetësim i përsëritur tashmë rregullisht këto vitet e fundit. Infrastruktura ligjore është plotësuar me kalimin e dy ligjeve, atij për shërbyesit civilë, si dhe ligjin për pagat e nëpunësve civilë, kërkesa këto të sindikatave. Ndonëse, legjislacioni deri diku mbron pavarësinë e shërbyesve civilë, në praktikë administrata publike e Kosovës edhe gjatë periudhës raportuese ka mbetur e tej politizuar, me ndërhyrje politike në emërimet e Sekretarëve Permanent e deri të punësimi i pastruesve. Edhe transparencja e sektorit publik mbulohet mjaft mirë me legjislacion, pavarësisht mangësive, por praktika është ndryshe, ku nuk ka zbatim të kënaqshëm të Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare. Fillimi i zbatimit të ligjit për deklarimin e pasurisë është një fillim i mirë, që do ta rrisë transparencën e sektorit publik, edhe pse edhe aty janë evidentuar mangësi.<sup>18</sup>

#### Lufta kundër korrupsionit

Për sa i përket sistemit ligjor për luftimin e korrupsionit, Qeveria ka sponsorizuar një pako ligjesh, të cilat nga shoqëria civile vlerësohen si mekanizma "pa dhëmbë" në zbardhjen dhe ndëshkimin e keqpërdorimeve. Në përgjithësi, Qeveria e Kosovës është duke treguar performancë të dobët të qeverisjes, si dhe është një ndër adresat më të kritikuar të të gjithë sistemit institucional. Sipas raportit të fundit të UNDP-së për paralajmërim të hershëm (faktet e shpejta), niveli i kënaqshmërisë së qytetarëve me Qeverinë është në nivelin 29% (në maj), që është për 7% më e ulët, se në janar të vitit 2010.<sup>19</sup>

Agjencitë e pavarura shtetërore, të cilat janë të thirrura ta mbrojnë interesin e përgjithshëm janë të pafuqishme, që t'i mbajnë institucionet shtetërore përgjegjëse për veprimet e tyre. Institucioni i Ombudspersonit injorohet nga ana e autoriteteve qendrore dhe lokale. Ministrinë dhe komunat angazhohen shumë pak

në bashkëpunim me këtë institucion. Arma kryesore e tij, e drejta për t'i sjellë institucionet që nuk ofrojnë informatat e kërkuara para gjykatës, i është hequr. Shumica e ankesave të dërguara te Ombudspersoni kishin të bënin me sistemin gjyqësor dhe administratën. Raportet dhe rastet, të cilat Agjencia Kosovare kundër Korrupsionit i dorëzon në prokurori injorohen. Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, që evidentojnë shumë shkelje në institucionet kosovare dhe mosmarrja e veprimeve nga prokurorët, ka qenë një pikë e nxehtë debati në mes të këtyre të fundit dhe mediave e shoqërisë civile. Organi Shqyrtues i Prokurimeve në fushën e prokurimit shpesh është akuzuar në media, si institucion i politizuar dhe është kritikuar ashpër nga Komisioni Evropian për mungesë transparence dhe profesionalizmi. Në fakt, institucionet e prokurimit kanë qenë më të kritikuarat në raportet e progresit të viteve 2009 dhe 2010 nga Komisioni Evropian, për mungesë transparence, profesionalizmi, mbikëqyrje efektive të aktiviteteve prokuruese, etj.

Në përgjithësi, sektori publik në Kosovë mbetet ndër sfidat kryesore të funksionalitetit shtetëror. Ndërtimi i një administrate profesionale, të përgjegjshme dhe përfaqësuese dhe ofrimi efikas i shërbimeve publike për qytetarët është sfida që kërkon adresim urgjent në nivelin politik. Partneriteti Evropian ka identifikuar si prioritet kyç reformën e administratës publike në Kosovë, ndërsa ky sektor edhe gjatë periudhës raportuese ka shënuar rezultate mjaft dekurajuese.

#### **2.3 Qeverisja lokale dhe procesi i decentralizimit**

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale (LVL) që hyri në fuqi në vitin 2008 ndërroi substancialisht sistemin e qeverisjes lokale në Kosovë ku Kryetari i Komunës tani zgjidhet me votë të drejtpërdrejtë nga qytetarët, cakton stafin ekzekutiv politik dhe ushtron pushtetin qeverisës në komunë. Ky ndryshim ka ngritur shumë dilema për llogaridhënien; balancën dhe kontrollin

<sup>18</sup> KDI & TIK, Studimi i Integritetit të Sistemit Institucional 2011, Gusht 2011

<sup>19</sup> Ibid 18.

ndërmjet dy pushteteve në nivel lokal të qeverisjes – Kuvendit dhe Kryetarit; tejkalimin e kompetencave dhe ushtrimin e pushtetit në mënyrë shpeshëherë autoritare nga ana e kryetarëve; mos definim të qartë të rolit të Kuvendit dhe stafit të tij. Për shkak të problemeve rreth zbatimit të LVL, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kishte përfshirë në agjendën e saj legjislative për vitin 2011 dhe kishte filluar procesin e ndryshimit të LVL. Mirëpo, ky proces është ndërprerë në mes të punës së tij, pasi që grupi punues nuk kishte arritur të gjente zgjidhje për dy çështje me rëndësi në lidhje me këtë ligj: 1) ndërmarrjet publike – nëse komunat kanë të drejtë të themelojnë dhe menaxhojnë me ndërmarrjet publike; 2) Kryesuesi i Kuvendit – nëse duhet ose jo të ekzistojë kjo pozitë dhe, në rast se po, çfarë roli dhe funksioni duhet të ketë. Në anën tjetër, respektimi i kërkesave të LVL-së, sikurse mekanizmat për përfshirjen direkte të qytetarëve në vendimmarrje; dispozitat për transparencën dhe llogaridhënien, kanë mbetur kryesisht në nivel të ulët ose shkelen nga ana e komunave. Kjo po reflekton në punën e komunave të Kosovës, të cilat nën arsyetimin se ligji është në ndryshim ose do të ndryshohet, ose nga mos njohuria e duhur e dispozitave të ligjit vazhdojnë të marrin vendime që shpeshherë janë në kundërshtim me LVL.<sup>20</sup>

Edhe gjatë kësaj periudhe, Ligji për Prishtinën, që është një kërkesë kushtetuese<sup>21</sup> ende nuk është aprovuar nga Kuvendi i Kosovës. Nxjerrja e këtij ligji, vazhdon të jetë i ndikuar politikisht nga raportet ndërmjet partive politike. Kjo situatë është duke dëmtuar Komunën e Prishtinës e cila do të mund të përfitonte shumë poqë se një ligj i tillë do të ekzistonte.

Në përgjithësi, ndryshimi i sistemit të qeverisjes lokale nuk ka dhënë rezultatet

<sup>20</sup> Komuna e Prishtinës kishte vendosur që mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa të mos jenë të hapur për publikun, përkundër që një gjë e tillë parashihej me LVL: poashtu edhe Komuna e Kacanikut ka marrë vendim për shpërbërjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi që është në kundërshtim me LVL-në.

<sup>21</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 13 (2008)

e pritura për zhvillimin e demokracisë lokale. Komunitat duhet të angazhohen edhe më shumë në arritjen e standardeve evropiane të qeverisjes lokale, duke krijuar balancë të duhur mes efikasitetit të ofrimit të shërbimeve publike dhe respektimit të parimeve demokratike të qeverisjes. Qeveria duhet sa më parë të ndryshoj LVL-në, duke përmirësuar gabimet teknike dhe adresuar problemet përmbajtësore të identifikuara gjatë zbatimit të LVL-së. Më tutje, Kuvendi i Kosovës duhet të aprovojë Ligjin për Prishtinën, duke mos e politizuar çështjen e nxjerrjes së një ligji të vecantë.

#### Pavarësia financiare (Buxheti)

Megjithëse bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale komunat duhet të kenë buxhetin dhe financat e tyre për të financuar punët dhe aktivitetet në kompetencë të komunës, këto të fundit ende varen në grantet qeveritare për realizimin e planeve të tyre. Problem mbetet marrëdhënia ndërmjet komunave dhe Ministrisë së Financave, (si dhe me Ministrinë e tjera të linjës), e cila karakterizohet me burokraci dhe procedura të tepërta, që shpeshherë u pamundësojnë komunave që të ushtrojnë në mënyrë efikase kompetencën e vet për përcaktimin e buxhetit. Përveç kësaj, komunat shpeshherë tregohen jo efikase në grumbullimin e të hyrave vetanake, sikurse janë tatimet dhe taksat e ndryshme komunale.

Përgjithësisht, komunat nuk janë të pavarura financiarisht. Procesi i decentralizimit fiskal nuk ka qenë në agjendën e qeverisë qendrore as gjatë periudhës raportuese. Në anën tjetër, komunat duhet të rrisin inkasimin e të hyrave vetanake në mënyrë që pavarësia financiare të jetë një realitet i prekshëm dhe jo vetëm një dëshirë ligjore dhe politike.

#### Raportet në mes ekzekutivit dhe legjislativit

Në Kuvendet Komunale vërehet qartë një cilësi jo shumë e lartë e këshilltarëve. Përveç mungesës së kuadrove të kualifikuara profesionale dhe politike



brenda degëve të partive politike të Kosovës, shihet se edhe pozita e anëtarit të Kuvendit Komunal nuk paraqet mundësi (ose karrierë politike) shumë atraktive për politikanët dhe profesionistët që veprojnë në nivelin komunal. Për më tepër, shumica e konflikteve mes Kryetarit të komunës dhe Kryesuesit të Kuvendit Komunal (dhe rrjedhimisht partive më të mëdha brenda kuvendeve), lindin si rezultat i interesave dhe ndikimeve të ndryshme politike mes fraksioneve të ndryshme përbrenda partive politike. Përvoja nga sistemi majoral kanë dëshmuar gjithashtu që Kryesuesve dhe këshilltarëve të Kuvendeve Komunale u ka munguar gatishmëria dhe vullneti për t'u përkujdesur për kushtet e tyre të punës dhe për t'i kapitalizuar përmbajtësisht kompetencat ligjore të institucionit që ata drejtojnë, sidomos në raport me Kryetarin e komunës. Paaftësinë e Kuvendit Komunal për të mbikëqyrë efektivisht Kryetarin e komunës e dëshmon edhe bindja e qytetarëve të anketuar në këtë hulumtim, mbi 70% e të cilëve mendojnë se anëtarët e Kuvendeve Komunale nuk e kryejnë ose deri diku e kryejnë punën e tyre si duhet.<sup>22</sup>

Në përgjithësi, marrëdhëniet ndërmjet pushtetit ekzekutiv dhe atij legjislativ lokal duhet të karakterizohen nga përgjegjësia që këto dy pushtete kanë para qytetarëve dhe para ligjit dhe jo në raportet e forcave politike brenda këtyre institucioneve. Partitë politike nuk janë treguar të përgjegjshme në ushtrimin e kontrollit dhe kërkimit të llogarisë nga ekzekutivi, sidomos nga Kryetarët e Komunave.

#### Përfaqësimi i qytetarëve në vendimmarrje

Organet Komunale kanë shënuar progres shumë të kufizuar në realizimin e parimit të subsidiaritetit në praktikë. Komunitat edhe më tutje nuk zbatojnë mekanizmat e demokracisë së drejtpërdrejtë dhe përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje.

Komunitat nuk ofrojnë mekanizma efikas dhe të cilët janë lehtësisht të përdorshëm

nga qytetarët në mënyrë që ata të jenë pjesë e marrjes së vendimeve dhe bërjes politikave me të cilat preken interesat e tyre. Në të shumtën e rasteve takimet e zyrtarëve komunalë me qytetarë për qëllime të informimit dhe konsultimit shërbejnë vetëm për të përmbushur obligimin ligjor. Në anën tjetër peticionet dhe iniciativat qytetare, edhe pse shumë të pakta në numër, nuk trajtohen në mënyrë adekuate. Kjo ka ndikuar edhe në pjesëmarrjen shumë të ulët të qytetarëve dhe mos-besim se vlerësimet dhe idetë e tyre kanë ndonjë rëndësi dhe do të merren parasysh.

Për më tepër, komunitat vazhdojnë t'u mohojnë qytetarëve dhe OJQ-ve pjesëmarrjen në Komitetet Konsultative sektoriale. Këto komitete të cilat duhet të shërbejnë si forum për diskutime dhe marrje të ideve nga qytetarët dhe shoqëria civile vazhdojnë të mbesin plotësisht të mbyllura, inekzistente apo jo-efektive.

Progres i kufizuar gjatë kësaj periudhe është shënuar në realizimin e marrëveshjeve nga disa Komuna me fshatra apo lagje të ndryshme për të decentralizuar vendimmarrjen.

Në përgjithësi, komunitat vazhdojnë të mos përfillin qytetarët dhe t'i trajtojnë ata me respekt duke mundësuar pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje. Institucionet lokale duhet të krijojnë mekanizma për përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje.

#### Barazia gjinore

Përfaqësimi i grave në nivel komunal nuk është i kënaqshëm, duke përfshirë si ekzekutivin e komunës ashtu edhe legjislativin. Aktorët më të rëndësishëm në promovimin e barazisë ligjore kanë mbetur OJQ-të dhe komuniteti ndërkombëtar.

Sa i përket ekzekutivit ende nuk ka asnjë grua e cila udhëheqë me Komuna të caktuara; numri i tyre është i kufizuar edhe në udhëheqje të drejtorive të ndryshme komunale. Përkundër faktit se gratë e kanë të garantuara pozitën e tyre në Kuvende Komunale përmes kuotave, ato vazhdojnë të jenë jashtë pozitave ku duhet ushtrojnë përgjegjësi, më konkretisht jashtë Komitetit

<sup>22</sup> BIRN – Sistemi i zgjedhjes së drejtpërdrejtë të kryetarit të komunës, Dhjetor 2010.

për Politikë dhe Financa, i cili paraqet komitetin kryesor të asamblesë dhe i cili diskuton të gjitha politikat e komunës, dokumentet fiskale dhe financiare, planet dhe iniciativat.

Në përgjithësi, barazisë gjinore nuk i është kushtuar vëmendje e posaçme në nivelin komunal dhe nuk është në agjendën e tyre si një çështje që duhet adresuar.

#### Komunitetet në Komunat e Kosovës

Struktura ligjore në Kosovë u garanton komuniteteve një pozitë shumë të favorshme në komunat në të cilat jetojnë, sidomos në ato komuna ku janë më shumë se 10% e popullsisë së përgjithshme apo janë shumicë. Me përjashtim të pjesëve të Kosovës ku institucionet vendore nuk kanë arritur të ushtrojnë sovranitetin, funksionimi dhe krijimi i komunave të reja ku shumicë paraqiten komunitete të ndryshme ka qenë i suksesshëm dhe është shënuar progres. Qytetarët në këto vende kanë filluar të kuptojnë rëndësinë dhe kompetencat e shumta të komunave dhe të shfrytëzojnë ato si adresë për problemet e komunitetit. Për më tepër ndihma dhe investimet e ndryshme nga komuniteti i donatorëve dhe Qeveria kanë ngritur kapacitet e këtyre komunave.

Në përgjithësi, komunitetet jo-shumicë kanë në dispozicion mekanizma të mjaftueshëm ligjor për të realizuar programet e tyre në kuadër të qeverisjes lokale, përderisa përdorimi i tyre në praktikë shpeshherë varet nga gjendja politike në Kosovë dhe influenca politike nga vendet tjera.

#### Arsimi

Arsimi fillor dhe ai i mesëm, si një prej përgjegjësive kryesore të komunave vazhdon të përballlet me probleme të ndryshme. Progres është arritur në ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme, si ndërtimi i shkollave të reja dhe renovimi i atyre ekzistuese. Përkundër kësaj, problemet e tilla si klasat e stërmbushura me nxënës nuk janë evituar në tërësi. Cilësia e arsimit nuk është në nivel të

kënaqshëm. Planprogramet dhe metodat e mësimdhënies nuk reflektojnë nevojat e tregut kosovar dhe atij evropian. Klasat e stërmbushura me nxënës dhe metodat e vlerësimit nuk garantojnë cilësi. Plani i Qeverisë për fillimin e mësimi të gjuhës angleze nga klasa e parë nuk përkon me kapacitet dhe numrin e mësuesve të kualifikuar të anglishtes që ka Kosova.

Aktet e dhunës dhe incidentet, prej të cilave edhe ato me pasoja fatale, vazhdojnë të paraqesin një dukuri shqetësuese në shkollat e Kosovës. Më pak se 50% e nxënësve në nivel kombëtar kanë arritur të diplomojnë nga shkolla e mesme.

Përgjithësisht, megjithëse arsimit vazhdon të jetë në reformë tashmë për shumë vite, progres i vogël është arritur në përmirësimin e gjendjes dhe rritjen e cilësisë së arsimimit. Institucionet duhet të rrisin përpjekjet e tyre për implementimin e reformave që i përshtaten standardeve evropiane të arsimit.

#### Shërbimet publike, zhvillimi ekonomik dhe të bërit biznes nëpër komuna

Përgjithësisht, shërbimet publike karakterizohen me burokraci dhe procedura të panevojshme. Përveç kësaj, cilësia e shërbimeve që ofrohen në shumicën e rasteve nuk i plotësojnë nevojat elementare të qytetarëve.

Të zhvillosh biznes në komunat e Kosovës vazhdon të mos jetë e lehtë, dhe ndër shumë faktorë me ndikim për këtë gjendje është edhe roli i vetë komunave. Nga rrethi i përgjegjësive të cilin e kanë për zhvillimin lokal ekonomik dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për të bërë biznes, komunat e Kosovës nuk kanë shënuar progres dhe nuk kanë ndërmarrë reformat e nevojshme për adresimin e këtyre problemeve.

Në këtë fushë përfshihet marrja e lejeve të punës dhe licencimi i bizneseve, lejet e ndërtimit, inspeksionet komunale, regjistrimi i pronave të paluajtshme, niveli i taksave dhe shumë të tjera. Në anën tjetër, organizimi institucional komunal karakterizohet me burokraci të madhe, hapa

të shumtë procedural dhe një administratë jo-profesionale e cila përpos që nuk është e gatshme t'u ofroje asistencë bizneseve paraqitet shpeshherë edhe si pengues në aktivitetin ditor të bizneseve. Edhe pse për shumë kohë është proklamuar ende në komunat nuk implementohet koncepti "one stop shop", me përjashtim të disa pilot projekteve të përkrahura nga USAID dhe BE.

Prishtina renditet ndër vendet e fundit në rajon për ambientin për zhvillim të biznesit (World Bank, Doing Business in South-East Europe). Sa i përket startimit të një biznesi, Prishtina renditet në vendin e 22 nga 22 qytete të rajonit si vendi më i papërshtatshëm i të bërit biznes. Në kategorinë e përmbushjes kontratës renditet në vendin e 21, në fushën e marrjes lejeve ndërtimit në vendin e 17 dhe sa i përket regjistrimit të pronës në vendin e 18. Gjendje e ngjashme paraqitet edhe në qendrat dhe komunat tjera.

Në përgjithësi, niveli komunal nuk ofron mbështetje e kërkuar për krijimin e një ambienti të përshtatshëm të të bërit biznes. Komunat karakterizohen me burokraci të madhe, numër të madh të hapave procedurale të cilët shpeshherë janë të panevojshme, dhe procedura të tejzgjatura kohore. Për më tepër niveli i taksave komunale mbetet shumë i lartë dhe administrata komunale joprofesionale në raport me bizneset. Kjo ka ndikuar që niveli i investimeve të huaja direkte të jetë më i ulëti në rajon.

#### Procesi i Decentralizimit

Përkundër posedimit të kornizës ligjore që reflekton parimet evropiane të qeverisjes lokale, edhe përgjatë vitit 2011 nuk është arritur që të përmbillet procesi i decentralizimit i filluar nga 2008. Pamundësia që të themelohet komuna e Mitrovicës së Veriut bazuar në kërkesat që dalin nga Pakoja e Ahtisaarit dhe strategjia qeveritare, si dhe mbetja jashtë kontrollit të komunës së Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit kanë rënduar funksionimin e qeverisjes lokale në përgjithësi. Tri komunat e fundit vazhdojnë të mbesin pa lidhshirë të

zgjedhur në mënyrë demokratike si pasojë e dështimit të organizimit të zgjedhjeve lokale në vazhdimësi, si dhe nuk ekziston asnjë bashkëpunim reciprok me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). Në zgjedhjet lokale të organizuara nga autoritetet e Kosovës në fillim të vitit 2010 është themeluar komuna e katërt me shumicë serbe në lindje të Kosovës, ajo e Parteshit. Qeveria e Kosovës ka alokuar rreth €2 milion dedikuar financimit të komunave të sapo-krijuara me shumicë serbe.<sup>23</sup>

Megjithatë, deri më tani themelimi i komunave të reja nuk ka arritur të zhbëjë ekzistimin e strukturave paralele serbe, duke përfshirë edhe operimin e shërbimeve serbe të sigurisë dhe inteligjencës.<sup>24</sup> Përveç kësaj, shteti i Serbisë ka vazhduar të financojë në komunat me shumicë serbe edhe sistemin e edukimit, shëndetësisë dhe shërbimeve publike paralele.

Përkundër perceptimit se sukcesi i procesit të decentralizimit do të ndihmonte në pajtimin ndër-etnik mes shqiptarëve dhe serbëve, efektet e filla nuk kanë prodhuar ndonjë sukses në veri të vendit. Megjithatë, MAPL dhe Zyra Ndërkombëtare Civile kanë mbetur të angazhuara që edhe për një kohë të pacaktuar të vazhdojnë planin aksionar duke u fokusuar në përkrahjen e Ekipit Përgatitor për themelimin e Komunës së Mitrovicës së Veriut e cila ka rezultuar me hapjen e një zyre në veri të Mitrovicës.<sup>25</sup> Në këtë kontekst, nuk është vërejtur përgjatë vitit 2011 ndonjë strategji e përbashkët mes Qeverisë së Kosovës dhe pranisë ndërkombëtare në drejtim të shfuqizimit të rolit të strukturave paralele serbe, si sfida kryesore e përfundimit të procesit të decentralizimit dhe futjes nën kontroll institucional të komunave në pjesën veriore.

Sfiduese mbetet edhe çështja e projekt-ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit

<sup>23</sup> Ibid 22.

<sup>24</sup> Freedom House, Country Report - Kosovo, Shtator 2011.

<sup>25</sup> Zyra Civile Ndërkombëtare, The International Civilian Representative (ICR) Pieter Feith's remarks at the conference 'Decentralization a Heavy Weight to be Carried Out' held in Prishtinë/Prishtina, 5 Korrik 2011, [http://www.ico-kos.org/ico/data/Image/Decentralization\\_a\\_heavy\\_weight\\_to\\_be\\_carried\\_out.pdf](http://www.ico-kos.org/ico/data/Image/Decentralization_a_heavy_weight_to_be_carried_out.pdf)

si dhe implementimi i Ligjit për Hoçën e Madhe që shtrihet në Komunën e Rahovecit, që në dy rastet ngërthen kompetenca me karakter ekstra-territorialiteti dhënë Kishës Ortodokse Serbe. Zyra Civile Ndërkombëtare ka vazhduar të ruajë pronësinë në tërë procesin e decentralizimit duke bërë presion tek Qeveria e cila në afat të shkurtër dhe pa debat me qytetarë ka dërguar në Kuvend Projektligjin për Qendrën Historike të Prizrenit, gjë që është refuzuar nga Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor. Sponsorizimi i këtij projektligji nga Qeveria është refuzuar fuqishëm edhe nga një koalicion i organizatave jo-qeveritare përmes peticionit me mbi 10.000 nënshkrime të qytetarëve të Prizrenit. "Qytetarët e nënshkruar konsiderojnë se hartimi i një ligji për Qendrën Historike të Prizrenit do të duhej të ishte një proces që i përfshin të gjitha palët e interesit. Për më tepër, vlerësojnë se një ligj i këtillë nuk guxon të krijojë privilegje për grupe të caktuara, e aq më tepër për komunitete të caktuara fetare."<sup>26</sup> Po ashtu, në rastin e miratimit në parim të Ligjit për Hoçën së Madhe më 1 Shtator 2011 në Kuvendin e Kosovës,<sup>27</sup> Kryetari i Rahovecit ka shprehur refuzimin për këtë ligj duke theksuar se është bërë në kundërshtim me vullnetin e tij dhe të gjithë qytetarëve të kësaj komune. Në përgjithësi, Zyra Civile Ndërkombëtare dhe Qeveria e Kosovës pa vullnetin paraprak të komunave përkatëse, Prizren dhe Rahovec, kanë tentuar dhe tentojnë që të shtrijnë ndikimin e decentralizimit asimetrik në këto rajone përmes arsytimit se këto kërkesa dalin nga pakoja e ligjeve të Ahtisaarit dhe si të tilla duhet të përkrahen.

## **2.4 Menaxhimi i zgjedhjeve**

### Konteksti politik

Në shtator të vitit 2010, Gjykata Kushtetuese nxorri aktgjykimin me konstatimin për shkelje serioze të Kushtetutës së Kosovës nga z. Fatmir

Sejdiu<sup>28</sup>. Ky aktgjykim rezultoi më pas me dorëheqjen z. Fatmir Sejdiu, nga pozita e Presidentit të Kosovës. Dy partitë më të mëdha kosovare që ishin në koalicion qeverisës nuk arritën të krijojnë një marrëveshje të re për president të ri dhe kjo mosmarrëveshje imponoi zgjidhjen kushtetuese që vendi të udhëhiqej me ushtrues detyre. Partitë politike zhvilluan agjendat e tyre politike dhe i artikuluan kërkesat për zgjedhje të parakohshme, si dalje nga kjo situatë politike, dhe për këtë u vendos që zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës do të mbahen më 13 shkurt 2011.

Pas këtij vendimi, LDK një ditë pas shpalljes së datës për zgjedhje vendos të dalë nga koalicioni qeverisës. Pas tërheqjes së LDK-së nga qeveria, Grupi parlamentar i Aleancës Kosova e Re, e përkrahur nga 40 nënshkrime të deputetëve, ndërmerr iniciativë për ngritjen e mocionit të mosbesimit për qeverinë Thaçi. Me 66 vota për, një kundër dhe dy abstenime, Kuvendi rrëzon qeverinë e Republikës së Kosovës<sup>29</sup>.

Pas miratimit të mocionit nga ana e Kuvendit, ushtruesi i detyrës së Presidentit të Republikës, z. Jakup Krasniqi, në përputhje të plotë me kompetencat e tij të garantuara me Kushtetutën e Kosovës, nxori dekretin që të shpërndajë Kuvendin e Kosovës dhe mori vendim që të ndryshojë datën e mbajtjes së zgjedhjeve nga 13 shkurti që ishte vendosur më herët, në 12 dhjetor në pajtim me afatet kushtetuese dhe ligjore në Kosovë.

Kosova për herë të parë u përball me organizimin e zgjedhjeve të parakohshme. Skenës politike kosovare i'u bashkëngjiten edhe dy subjekte të reja politike të cilat garonin për herë të parë në zgjedhje - Lëvizja Vetëvendosje e udhëhequr nga Albin Kurti dhe partia Fryma e Re (FER) e drejtuar nga udhëheqës të shquar nga shoqëria civile.

### Kuadri Ligjor dhe Sistemi Zgjedhor

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare u

<sup>26</sup> Zëri, Dorëzohet në Kuvend peticioni për Qendrën e Prizrenit, 19 Shtator 2011.

<sup>27</sup> Koha Ditore, Hoça e Madhe, si pushtet i tretë, 2 Shtator 2011.

<sup>28</sup> <http://www.demokracianeveprim.org>. Raporti i Vëzhgimit të Zgjedhjeve Parlamentare 2010.

<sup>29</sup> <http://www.voanews.com>

zhvilluan me një kornizë ligjore të plotësuar krejt sipërfaqësisht dhe me procedurë të përshpejtuar nga Kuvendi i Kosovës vetëm një muaj e gjysmë para mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Afati i shkurtër kohor për reformim të mirëfilltë të ligjit zgjedhor, la shumë çështje pa zgjidhur si: shkalla e pragut zgjedhor, ndarja e Kosovës në më shumë zona elektorale, etj.

Megjithatë nga ndryshimet e bëra në ligjin zgjedhor duhet vlerësuar vetëm këto çështje: përcaktimi i afateve kohore për PZAP30 dhe Gjykatën Supreme, të cilat ndikuan pozitivisht në përmbylljen e procesit zgjedhor deri tek certifikimi i rezultateve; votimi preferencial me mundësi të votimit për 5 kandidatë, si dhe heqja e gjobave për organizatat monitoruese vendore. Ligji aktual për zgjedhjet e përgjithshme e përcakton Kosovën si një zonë të vetme zgjedhore me sistem të përfaqësimit proporcional<sup>31</sup>. Edhe pse në vete ngërthen një mori mangësish, sistemi proporcional në Kosovë deri pas zgjedhjeve të fundit parlamentare nuk ka qenë asnjëherë temë për ndryshim në mesin e aktorëve kryesor të zgjedhjeve. Krijimi i disa zonave zgjedhore do të kishte përparësi të mëdha, ku më kryesorja do të ishte rritja e përfaqësimit të qytetarëve dhe ndërlidhja më e madhe në mes të deputetëve dhe qytetarëve<sup>32</sup>.

Sistemi zgjedhor me një zonë vazhdimisht ka rrezikuar përfaqësimin e gjerë elektoral në Kuvendin e Kosovës. Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, në nenin 110 pika 1, Kosovën e konsideron një zonë unike zgjedhore me shumë kandidatë. Rezultatet e zgjedhjeve të 12 dhjetorit 2010, disa komuna i la të pa përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës. Po ashtu disa komuna jo shumë të mëdha për nga numri i banorëve, kanë arritur të kenë numrin më të madh të deputetëve. Raste të tilla padyshim se dëshmojnë për urgjencën e ndryshimit

30 Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

31 [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L073\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L073_al.pdf)

32 <http://www.kdi-kosova.org>. Reforma në Sistemin Zgjedhor të Kosovës

të kornizës ligjore të zgjedhjeve, me theks të veçantë në krijimin e disa zonave zgjedhore<sup>33</sup>.

#### Organet e administrimit të procesit zgjedhor (KQZ, PZAP, Gjykata Supreme)

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka pasur një kohë relativisht të shkurtër në organizmin e procesit zgjedhor. Si pasojë, janë vërejtur mjaft parregullsi, të cilat në një masë kanë ndikuar në dëmtimin e procesit zgjedhor. Parregullsitë e evidentuara konsistojnë në raste, ku materiali i domosdoshëm zgjedhor nuk ka qenë i pranishëm në të gjitha vendvotimet ose ka shkuar me vonesë në disa prej tyre. Në shumë vendvotime nuk kanë funksionuar fare llambat ultravjollcë, për shkak të cilësisë së dobët. Në disa qendra, sprej për spërkatjen e gishtit ka qenë i nivelit tejet të dobët. Zgjedhja jo e duhur e anëtarëve të KVV-ve në disa komuna të Kosovës (ku ishin përfshirë në manipulimin e votave), rezultoi me përsëritjen e votimeve në disa komuna të Kosovës. Mbledhjet e KQZ-së kanë qenë të hapura, ku janë përcjellë edhe nga vëzhguesit dhe përfaqësuesit e mediave. Por, puna e KQZ-së është ndikuar nga përkatësia partiake e anëtarëve të Komisionit<sup>34</sup>.

Ndryshimet e bëra në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, sidomos përcaktimi i afateve kohore për PZAP-in dhe Gjykatën Supreme kanë dhënë rezultate pozitive në përmbylljen e procesit zgjedhor deri tek certifikimi i rezultateve. Për shkak të numrit të madh të ankesave të bazuara në fakte bindëse për Panelin Zgjedhor për ditën e votimit 12 dhjetor 2011, ky i fundit mori vendim që të udhëzojë KQZ-në për përsëritjen e zgjedhjeve në disa komuna: Drenas, Skenderaj dhe Deçan, si dhe përsëritjen e procesit të votimit në Komunën e Lipjanit dhe të Malishevës. KQZ vendosi që në këto vende të përsëriten zgjedhjet, ndërkohë që pas vendimit të Gjykatës

33 <http://www.kdi-kosova.org>. Vota ime. Legjislatura e IV e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

34 Raporti i ENEMO's.

Supreme, KQZ vendosi që edhe në Mitrovicë të përsëriten zgjedhjet.

#### Listat Zgjedhore

Lista Përfundimtare e Votuesve (LPV) për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2010 bazohet në Ekstraktin e Regjistrimit Civil, i cili është përpiluar nga Agjencia për Prodhimin e Dokumenteve (APD), në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Lista Përfundimtare e Votueseve për zgjedhjet e 12 dhjetorit 2010 kishte 1,630,636 emra të votuesve të ndarë në 37 komuna, me një rritje prej 73,288 apo 4,4% në krahasim me zgjedhjet e kaluara. Përkundër faktit që KQZ-ja ka bërë një punë të mirë për pastrimin e listave të votuesve, ky problem në një masë shumë të madhe është ende i pranishëm<sup>35</sup>.

#### Fushata zgjedhore

Fryma e fushatës zgjedhore në tërësinë e saj ishte relativisht e qetë, e zhvilluar lirish dhe pa ndonjë pengesë të madhe, në përjashtim të disa incidenteve të vogla (të izoluara). Megjithatë fushatën elektorale për zgjedhjet e 12 dhjetorit, e shënuan disa raste të shkeljes së Kodit të Etikës nga subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre si: dëmtimi i materialit propagandues nga ana e partive politike, keqpërdorimi i resurseve publike, prania e fëmijëve në shumë aktivitete të subjekteve politike, vendosja e materialit propagandues në objekte publike, fjalori fyes dhe kërcënimet, e deri te mosparaqitja e kalendarit të aktiviteteve të subjekteve politike në KKZ. Edhe pse koha ishte e kufizuar për fushatë elektorale (vetëm 10 ditë), megjithatë, ranë në sy shpenzimet e mëdha të subjekteve politike gjatë fushatës elektorale, sidomos të partive të mëdha.

#### Procesi i ditës së votimit 12 dhjetor 2010

Në bazë të vlerësimit të vëzhguesve vendorë dhe ndërkombëtarë të procesit të ditës së votimit të 12 dhjetorit 2010, është raportuar për një numër të madh të

parregullsive gjatë këtij procesi, të cilat në masë të caktuar kanë ndikuar në rezultatin final. Parregullsitë e evidentuara ishin: numri i fletëvotimeve në kuti tejkalonin numrin e të nënshkruarve në regjistrin e votuesve, falsifikimi i nënshkrimeve në Listën e Përfundimtare të Votuesve (ku një person ka nënshkruar për disa të tjerë), votimi familjar, mos kontrollimi i dokumenteve identifikuese, prezenca e vazhdueshme e personave të paautorizuar nëpër vendvotime, asistimi i votuesve nga ana e vëzhguesve të partive politike, keqpërdorimi i pozitës së menaxherëve të qendrave të votimit, votimet e hapura dhe fotografimi i votave nga shoqëruarit e votuesve.

#### Rivotimi 9 janarit 2011

Pas vendimeve të marra nga PZAP lidhur me ankesat e subjekteve politike dhe organizatave të shoqërisë civile për manipulim të procesit zgjedhor të 12 dhjetorit 2010, KQZ mori vendim për shpalljen e rivotimit në tri komuna dhe dy qendra të votimit më 9 janar 2011. Kështu, në Komunën e Skenderajt, Drenasit dhe Deçanit u rivotua, kurse në Komunën e Malishevës dhe atë të Lipjanit u votua vetëm në një qendër të votimit. Procesi i rivotimit në pesë komunat e Kosovës është përcjellë në një masë me parregullsitë të cilat e kanë shoqëruar edhe procesin zgjedhor të 12 dhjetorit 2010. Përkundër ndërrimit të komisionarëve nga ana e KQZ-së, nuk janë evituar parregullsitë e 12 dhjetorit<sup>36</sup>.

#### Rivotimi 23 janar 2011

Pas vendimit të Gjykatës Supreme për rivotim në Komunën e Mitrovicës, Komisioni Qendror Zgjedhor solli vendim që votimi për zgjedhje parlamentare në këtë komunë të përsëritet më 23 janar 2011. Procesi i rivotimit në komunën e Mitrovicës me 23 janar 2011, përkundër disa parregullsive të vogla, është vlerësuar si një proces zgjedhor i qetë, i rregullt dhe demokratik.

<sup>35</sup> <http://www.demokracianeveprim.org>. Raporti i Vëzhgimit të Zgjedhjeve Parlamentare 2010.

<sup>36</sup> <http://www.demokracianeveprim.org>. Raporti i Vëzhgimit të Zgjedhjeve Parlamentare 2010.

Megjithatë shqetësues është vlerësuar fakti i daljes në votime të një numri e tejet të vogël të qytetarëve të komunës së Mitrovicës.

#### Ndryshimi i legjislacionit zgjedhor në Kosovë

Parregullsitë e mëdha që i shoqëruan zgjedhjet e fundit parlamentare, si dhe kriza institucionale e krijuar pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese për Presidentin, liderët e tri partive politike PDK, LDK dhe AKR, arritën një marrëveshje politike për zgjedhjen e Presidentit të ri, si dhe u pajtuan për fillimin një procesi për reformimin e legjislacionit zgjedhor dhe ndryshimin e Kushtetutës. Marrëveshja më pastaj u inkorporua në Rezolutë e cila u miratua nga Kuvendi i Kosovës, ku parashiheshin ndryshimet kushtetuese në formën e zgjedhjes së Presidentit: votim qytetar për zgjedhjen e Presidentit, si dhe krijimi i më shumë zonave zgjedhore në Kosovë<sup>37</sup>. Kjo Rezolutë ka përcaktuar edhe afatet kohore se kur duhet të përfundojnë këto çështje. Kuvendi i Kosovës ka themeluar dy komisione të veçanta parlamentare të cilat janë duke punuar intensitet në këto çështje: Komisionin për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Komisionin për amendamentimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

#### Shoqëria civile dhe zgjedhjet

Zgjedhjet e 12 dhjetorit 2010 dhe rivotimet që pasuan u monitoruan nga një prani e konsiderueshme e organizatave të shoqërisë civile. Problemet strukturale rreth menaxhimit të zgjedhjeve ndikuan edhe në vështirësi të caktuara në procesin e monitorimit të zgjedhjeve. Shoqëria civile nuk ka arritur të dëshmojë nivel të kënaqshëm të përgjegjësisë në këtë proces, dhe kjo ka zbehur edhe më shumë kredibilitetin e situatës së përgjithshme zgjedhore, situatës së përgjithshme zgjedhore, e cila ishte larg standardeve demokratike.

<sup>37</sup> <http://www.kuvendikosoves.org>. (Rezoluta e Kuvendit të Kosovës).

## **2.5 Sundimi i ligjit dhe sistemi i drejtësisë**

Sundimi i ligjit mbetet një ndër segmentet me më pak progres në tërë territorin e Kosovës. Pjesa më sfiduese e sundimit të ligjit edhe përgjatë vitit 2011 mbeti Veriu i Kosovës, përkatësisht komunat e Leposaviqit, Zveçanit, Zubin Potokut, dhe komuna e pathemeluar e Mitrovicës së Veriut. Gjykatat vazhduan të mbesin jashtë funksionalizimit, gjë që ka pamundësuar qasjen në drejtësi për qytetarët dhe për veprimet e Policisë së Kosovës për zbatimin e ligjit në mënyrë simetrike.

Veprimi i strukturave ilegale serbe (të policisë, inteligjencës, gjyqësisë) në tërë territorin e Kosovës, të mbështetura nga Qeveria e Serbisë dhe me theks të veçantë në Veri, ka dëshmuar për progresin e pamjaftueshëm, dhe mungesën e vullnetit politik dhe të vendosmërisë nga ana e institucioneve të Kosovës dhe atyre ndërkombëtare për të ofruar siguri, rend dhe ligj për të gjithë qytetarët, pavarësisht vend-banimit apo përkatësisë etnike. Karakteristikë mbetet vazhdimi i pranisë ndërkombëtare nën Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe mungesën e rikonfigurimit të kësaj pranije për të qenë në përputhje me realitetin dhe rrethanat e krijuara pas shpalljes së Pavarësisë.<sup>38</sup>

Misioni i UNMIK-ut<sup>39</sup> ka mbajtur prezencën e tij në komunat e Veriut, duke njohur vetëm realitetin para 17 Shkurtit 2008, kurse prania e Misionit për sundim të ligjit të Bashkimit Evropian, EULEX, në sferën e drejtësisë mbetet nën një prani minimale që mbulon vetëm rastet urgjente me motive kriminale dhe ndëretnike në gjykatën e qarkut në pjesën veriore të Mitrovicës.<sup>40</sup> Deri më tani janë të angazhuar vetëm gjashtë gjyqtarë të EULEX-it dhe katër prokurorë, kurse gjyqtarët dhe prokurorët shqiptarë punojnë në normë jo të plotë 'në ekzil' në qytetin e Vushtrrisë

<sup>38</sup> Freedom House, Country Report - Kosovo, Shtator 2011.

<sup>39</sup> Forumi për Sigurisë, Zbatimin Politik i Ligjit në Kosovë, Prill 2011

<sup>40</sup> QKSS, Rithemelimi dhe Reformimi i Sistemit të Drejtësisë në Kosovë, Maj 2011.

dhe janë të angazhuar vetëm në seanca paragjyqësore.<sup>41</sup> Në këtë drejtim, EULEX ka dëshmuar performansë të dobët sa i përket hetimeve dhe ndjekjeve penale të krimeve.

Për shkak të mungesës së unitetit të brendshëm të BE-së në raport me Kosovën, EULEX nuk ka ndonjë arritje në përmbushjen e mandatit të tij ekzekutiv sidomos në pjesën veriore të vendit. Si pasojë, vendosja e një sistemi juridik unik dhe ushtrimi i juridiksionit gjyqësor apo prokurorial në tërë territorin e Kosovës ende nuk është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.<sup>42</sup> Përkundrazi vazhdimi i ushtrimit të autoritetit gjyqësor e prokurorial të EULEX-it nën kornizën e neutralitetit ndaj statusit në kuadër të Rezolutës 1244 ka krijuar një sistem juridik të dyfishtë asimetrik, mjaft të rrezikshëm për shtetësinë e Kosovës.

Megjithatë, gjatë pjesës së dytë të vitit nga 25 Korriku 2011, Qeveria e Kosovës ka hapur mundësinë për krijimin e rrethave të reja duke ndërmarrë veprime në drejtim të rikthimit të kontrollit doganor në pikat 1 dhe 31 përmes dërgimit të zyrtarëve të Doganave të Kosovës dhe policë. Ky veprim u kundërshtua fuqishëm nga strukturat ilegale të veriut, Qeveria e Serbisë dhe një pjesë e bashkësisë ndërkombëtare. Deri në këtë fazë të raportimit, është vërejtur një vendosmëri e theksuar e Qeverisë që të funksionalizojë agjencitë e zbatimit të ligjit fillimisht në pikat kufitare në drejtim të unifikimit të zonës doganore si një dhe e vetme në tërë territorin e Kosovës, përkundër djegies së pikës doganore-kufitare 1 më 27 Korrik 2011. Përkundër faktit që rol të rëndësishëm në rikthimin e kontrollit doganor-kufitar në pikat 1 dhe 31 ka luajtur KFOR-i në kuptim të mbështetjes logjistike dhe ruajtjes së sigurisë në këto dy pika, aksionet e fundit në Veri nuk e kanë zgjidhur problemin e kontrollit të vijës së gjelbër kufitare, pasi që në ndërkohë janë hapur kalime tjera ilegale të cilat në masë të konsiderueshme kanë relativizuar vet

efektin e kësaj ndërhyrjeje. Për më tepër, shkëputja e zinxhirit komandues brenda Policisë së Kosovës paraqet rrezik potencial në përkeqësimin e sundimit të ligjit dhe sigurisë në këtë pjesë të Kosovës.

Edhe pse në planin strategjik bashkëpunimi i Qeverisë së Kosovës me EULEX-in dhe Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në kuadër të Bordit Koordinues për Sundim të Ligjit vazhdoj së funksionuari,<sup>43</sup> ky bashkëpunim ishte më tepër formal e teknik dhe në këtë kontekst nuk ka mundur të ndikoj në ngritje të nivelit të implementimit të legjislacionit ekzistues i cili edhe më tutje është në nivel të duhur. Për më tepër, është vërejtur një nguti në drejtim të përshpejtitimit të aktiviteteve të përbashkëta për të përmbushur planin për miratim të legjislacionit të parashtruar nga Komisioni Evropian, duke anashkaluar pjesëmarrjen kualitative nga ana e shoqërisë civile si dhe pa zhvillim të ndonjë debati substancial brenda Kuvendit.

#### Sistemi i drejtësisë

Përkundër se janë ndërmarrë disa hapa në përmirësimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë, ky sektor vazhdon të mbetet i dobët. Që nga miratimi i Ligjit mbi Gjykatat dhe disa ligjeve tjera që kanë të bëjnë me organizimin e gjyqësorit vitin e kaluar, nuk është arritur ndonjë progres i mëtutjeshëm substancial në nxjerrjen e legjislacionit të nevojshëm në përmblylljen e reformave të drejtësisë dhe në përpjekjet për implementim dhe funksionalizimin e këtij sistemi. Një ndër shkaktarët për këtë ngecje ka qenë kriza parlamentare ku institucionet kryesore që do duhej të punonin në miratimin e tyre u gjendën jashtë funksionimit normal të tyre për gjashtë muaj.

Nuk u arrit të miratohen, ndryshohen apo/dhe plotësohen pjesa më e madhe e legjislacionit e paraparë në Strategjinë Legjislative 2011 që mbulon fushën e drejtësisë. Pati ngecje në amendamentimin dhe plotësimin e Ligjit të Policisë, Kodit

41 International Crisis Group, North Kosovo: Dual Sovereignty in Practice, Mars 2011.

42 Ibid 41.

43 EULEX, Programme Report Bolstering the Rule of Law in Kosovo: A Stock Take, Shtator 2011.



Penal, Kodit të Procedurës Penale, miratimin e Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale, etj.,<sup>44</sup> edhe pse këto ligje ndërlidhen direkt me funksionalizimin dhe fuqizimin e sistemit të drejtësisë.

Një fakt tjetër shqetësues është që pjesa më e madhe e legjislacionit në fushën e sundimit të ligjit dhe sistemit të drejtësisë është duke u hartuar pa pjesëmarrje të shoqërisë civile dhe medias.

Nuk ka pasur progres në ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal dhe atij të Procedurës Penale ndonëse këto dy akte janë pjesë kyçe e reformimit të sistemit të drejtësisë në përgjithësi.

Krahasuar me periudhën paraprake raportuese hapa të rëndësishëm janë arritur me miratimin e ligjeve për Këshillin Gjyqësor<sup>45</sup> dhe atë Prokuroral<sup>46</sup>. Po ashtu gjatë kësaj periudhe është arritur edhe konsolidimi i këtyre institucioneve në një proces të konsideruar si kryesisht demokratik. Megjithatë, me përjashtim të faktit të themelimit të këtyre dy Këshillave deri më tani nuk vërehet ndonjë rezultat konkret nga puna e tyre.

Ndërkohë, është arritur progres në procesin e ri-emërimit dhe emërimit të gjykatësve dhe prokurorëve. Ky proces i mbajtur për herë të parë poashtu i hapi rrugën edhe rekrutimit të gjyqtarëve të ri. Ndonëse një numër i madh i gjyqtarëve dhe prokurorëve dështuan të kalojnë me sukses vlerësimin përkundër përvojave shumëvjeçare në ato pozita, deri më tani nuk ka pasur ndonjë vlerësim tjetër rreth performancës së tyre gjatë ushtrimit të detyrës si gjyqtar apo prokuror. Po ashtu probleme pati edhe me rekrutimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj duke aluduar në politizimin e këtij procesi, si nga partitë politike opozitare ashtu edhe nga një pjesë e shoqërisë civile.<sup>47</sup>

44 Strategjia Legjislative 2011, Kuvendi i Kosovës, Mars 2011

45 Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Kuvendi i Kosovës, Tetor 2010

46 Ligji për Këshillin Prokuroral të Kosovës, Kuvendi i Kosovës, Tetor 2010

47 FIQ & KDI, Procesi i Ri-Emërimit, Pavarësia dhe Ndikimet (Riemërimet dhe Emërimet e Gjykatësve dhe Prokurorëve në Kosovë)

Në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar situata ende mbetet e njëjtë me periudhën paraprake raportuese. Deri më tani nuk ka pasur ndonjë agjendë të ngjeshur në shtimin e marrëveshjeve bilaterale ndërshtetërore për sa i përket ekstradimit. Një numër shumë i vogël i marrëveshjeve është arritur. Ndërkohë, sa i përket Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar, ndonëse ka kaluar leximin e parë në Kuvendin e Kosovës, ende nuk dihet ndonjë datë e saktë se kur ky ligj do të miratohet.

Krahasuar me periudhën paraprake, deri më tani në fushën e mbrojtjes së dëshmitarëve është arritur miratimi i legjislacionit relevant<sup>48</sup>. Megjithatë vazhdojnë të mungojnë mekanizma të nevojshme për implementimin e tij. Ligji bart një kosto të lartë financiare mbase do të duhej të i mundësonte strehim dhe mbështetje permanente dëshmitarëve të mbrojtur. Mbetet e paqartë se krahas ofrimit të mbështetjes së dëshmitarëve në territorin e Kosovës a do të arrihet e njëjta të bëhet në marrëveshje me shtetet e tjera për dërgimin e tyre jashtë vendit – duke pasur parasysh një territor të vogël ku dekonspirimi i tyre, dhe si rrjedhojë siguria fizike do të ishte problem i madh.

Progres të limituar ka pasur në zhvillimin e kapaciteteve të qendrave të rehabilitimit. Në fakt Sistemi Korrektues i Kosovës edhe më parë ka gëzuar kapacitete relativisht të kënaqshme. Fillimi i ndërtimit të një burgu të sigurisë së lartë në fshatin Dyz të Podujevës edhe më tutje avancoi progresin në këtë fushë.

Ndihma juridike që ju ofrohet personave të privuar nga liria është në nivel të pakënaqshëm. Ankesa të mëdha nga kjo kategori e njerëzve ka sidomos kur bëhet fjalë për lirinë me kusht dhe përfitimin nga amnistia. Në lidhje me ndihmën juridike të personave të privuar nga liria, avokatët e caktuar sipas detyrës zyrtare në masë të madhe nuk konsultohen me klientët e tyre dhe nuk i vizitojnë fare ata në qendrat

48 Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve, Kuvendi i Kosovës, Shtator 2011

e mbajtjes (ndalimit). Nuk ka ndonjë mekanizëm i cili merret me verifikimin dhe vlerësimin e angazhimit të tyre ndaj klientëve. Ankesa të mëdha ka edhe ndaj komisioneve për lirim me kusht të cilat në të shumtën e rasteve dyshohen të jenë mjaft të korruptuara në procesin e përzgjedhjes së përfituesve nga kjo masë.

## 2.6 Prokurimi publik

Korniza ligjore e cila rregullon Prokurimin Publik në Kosovë në dy vitet e fundit është amendamentuar dy herë. Më 2011, iniciativa për ndryshimin e Ligjit për Prokurimin Publik ka ardhur si pasojë e vlerësimit negativ që Qeveria e Kosovës ka marrë në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian sa i përket bazës së mangët ligjore. Edhe pse Qeveria e Kosovës ka miratuar ligjin e ri të prokurimit publik,<sup>49</sup> i cili është aprovuar nga Kuvendi dhe ka hyrë në fuqi me dekretimin nga Presidenca e Republikës së Kosovës, ky ligj nuk përmban ndonjë ndryshim pozitiv sa i përket ngritjes së transparencës dhe llogaridhënies së procedurave të prokurimit.

Asnjë nga rekomandimet e shoqërisë civile që kanë qenë pjesë e grupit punues për ndryshimet në këtë ligj nuk janë marrë parasysh përpos paragrafit 2 të nenit 26 ku parashihet që për çdo tender me vlerë të madhe, kontratat të nënshkruhen vet nga ministri i ministrisë përkatëse, kryetari i komunës apo çdo drejtor përkatës i autoritetit kontraktues. Të gjitha rekomandimet tjera të ofruara nga shoqëria civile kanë qenë në përputhje me Direktivat 2004/17 dhe 2004/18 për Prokurim Publik të Bashkimit Evropian<sup>50</sup>. Përafrimi dhe

49 Kuvendi i Republikës së Kosovës (2011). Ligji Nr. 04/L-042 për prokurimin publik në Republikën e Kosovës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 18 / 19 shtator 2011, Prishtinë

50 Direktiva 2004/17/EC, është miratuar në mars të vitit 2004, parasheh procedurat e planifikimit dhe menaxhimit të proceseve të prokurimit sa i përket projekteve me subjektet që veprojnë në "sektorët e veçantë" të ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare.

Direktiva 2004/18/EC, e miratuar në mars 2004, parasheh rregullat mbi koordinimin e procedurave për dhënien e kontratave të punëve publike, kontratave publike të furnizimit dhe kontratave për shërbimet publike.

Rekomandimet e shoqërisë civile kanë qenë në përputhje të plotë me dispozitat që rregullojnë transparencën e procesit të prokurimit dhe realizimit të kontratave publike, përshtatshmërisë dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit, mjeteve tradicionale dhe elektronike të komunikimit dhe procesit të mbikëqyrjes së

adoptimi i këtyre direktivave në kuadër të kornizës ligjore të Prokurimit Publik do të ndihmonte në ngritjen e transparencës së procedurave të prokurimit dhe minimizimin e korrupsionit dhe keqpërdorimit të parasë publike gjatë realizimit të këtyre procedurave.

Agjencia e Prokurimit Publik (APP), gjatë vitit 2010 ka shënuar të njëjtin ritëm sa i përket dhënies së tenderëve njëburimor nga ana e institucioneve publike. Sipas të dhënave "vlera e kontratave të fituara përmes tenderëve njëburimor apo dhënia e tenderëve vetëm me një ofertë, ka shënuar një rënie të lehtë nga 200 milionë euro sa i ishte vlera e tyre në vitin 2009, në 170 milion euro në vitin 2010"<sup>51</sup>. Kjo rënie shënon një përparim modest në menaxhimin e prokurimit publik pasi që praktika e dhënies së tenderëve njëburimor ka qenë më problematike dhe më e kritikuar nga Komisioni Evropian dhe institucione të tjera.. Të pakënaqura me vendimet e APP-së, autoritetet kontraktuese kanë parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) kërkesa për rishqyrtimin e vendimeve të APP-ës<sup>52</sup>, apo ankesa të cilat kanë të bëjnë me moslejimin e përdorimit të procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë apo revokim të nenit 30 A. 4 të LPP-ës, njohur ndryshe si tenderët një burimorë.

OSHP gjatë viti 2010 ka shqyrtuar gjithsejtë 155 kërkesa të autoriteteve

realizimit të kontratave publike.

Përmbledhje e përgjithshme e Direktivave:

[http://europa.eu/legislation\\_summaries/internal\\_market/businesses/public\\_procurement/l22009\\_en.htm](http://europa.eu/legislation_summaries/internal_market/businesses/public_procurement/l22009_en.htm)

Direktiva 2004/17/EC:

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2004:134:0001:0113:en:PDF>

Direktiva 2004/18/EC:

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:32004L0018:EN:NOT>

European Commission (2004). Direktiva 2004/17/EC e Parlamentit dhe Këshillit Evropian.

<http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2004:134:0001:0113:EN:PDF>

European Commission (2004). Direktiva 2004/18/EC e Parlamentit dhe Këshillit Evropian.

<http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2004:134:0114:0240:EN:PDF>

51 Friedrich-Erbert-Stiftung & Instituti Riinvest (2011). Punim Udhëzues: Sfidat Ekonomike 2011 Plus. Prishtinë. [http://www.fes-prishtina.org/eb/media/pdf/FESRIINVESTALBANIAN\(fin\).pdf](http://www.fes-prishtina.org/eb/media/pdf/FESRIINVESTALBANIAN(fin).pdf)

52 Lëvizja FOL (2011). Raporti i Monitorimit të prokurimit. Si pasojë e shkeljeve të ligjit të prokurimit rrezikojmë të humbim miliona euro. Prishtinë. [http://www.levizjafol.org/images/uploads/files/Raporti\\_i\\_Monitorimit\\_te\\_Prokurimit\\_Publik.pdf](http://www.levizjafol.org/images/uploads/files/Raporti_i_Monitorimit_te_Prokurimit_Publik.pdf)

kontraktuse kundër vendimeve të APP-së. Nga këto, 42 kërkesat e bëra nga Autoritetet Kontraktuese në OSHP kanë të bëjnë me kërkesën për revokim të nenit 30A. 4, ku 33 prej tyre kërkesa janë aprovuar, kurse 9 të tjera janë refuzuar – nuk janë lejuar tenderët një burimorë<sup>53</sup>. Mangësitë kryesore të APP-së kanë të bëjnë me nivelin e ulët të transparencës së këtij institucioni. Ky agjencion nuk ka as ueb-faqe aktive e cila do të shërbente si mekanizëm i ofrimit të informacioneve të APP-së, gjithashtu ky institucion nuk ka bërë asnjë vendim të saj publik si dhe nuk ka hartuar raport vjetor të cilin do ta kishte obligim ta prezantonte në Kuvendin e Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), ose që ndryshe njihet si organi i trajtimit të ankesave, gjatë vitit 2010, ka pranuar 430 ankesa të operatorëve ekonomik kundër vendimeve të autoriteteve kontraktuese, nga të cilat ka shqyrtuar 331 ankesa. Nga ky numër vetëm për 62 raste paneli shqyrtues i OSHP-së, ka marrë vendim për anulimin e aktivitetit të prokurimit (ri-tenderim), si pasojë e konstatimit të shkeljeve të dispozitave të LPP-së, për parregullsitë në dosjet e tenderit apo për zhvillimin me mangësi të procedurave të prokurimit. Sikurse në vitet paraprake, ankesat janë kryesisht në procedurat tenderuese në vlerë të lartë (77 milion euro), kurse më pak ankesa ka për tenderët me vlerë të mesme dhe të ulët<sup>54</sup>.

Sa i përket ankesave për shkelje të ligjit, të cilat i ka shqyrtuar OSHP, prinë Korporata Energjetike e Kosovës (KEK). KEK-u ka mbyllur vitin 2010 me 25 ankesa kundër tenderëve të saj, ku 2 prej tyre përfunduan

në rivlerësim, kurse 7 janë anuluar, që të nisin procedura të reja. Në drejtim të OSHP-së, i cili ka për mandat shqyrtimin e ankesave, janë drejtuar shumë akuza sa i përket vendimeve të këtij organi, të cilat akuza ngrisin dyshime rreth pavarësisë, paanshmërisë dhe ligjshmërisë së vendimeve të këtij institucioni<sup>55</sup>.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP), në bazë të ligjit mbi prokurimin publik është përgjegjës për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik në Kosovë<sup>56</sup>. Ky institucion në vitin 2010 ka pasur një progres të kufizuar në hartimin e legjislacionit sekondar si obligime të dala nga ligji i ri i prokurimit i miratuar në vitin e kaluar. Sipas raportit vjetor të Auditorit Gjeneral për vitin 2010, mungesa e udhëzuesve të brendshëm për prokurim publik dhe vonesat në hartimin e udhëzuesve, nuk e kanë bërë të lehtë implementimin e këtij ligji<sup>57</sup>. KRPP ka arritur që në një masë të konsiderueshme të mirëmbajë ueb-faqen informative, që i ofron publikut qasje të pakufizuar për të gjitha informacionet që kanë të bëjnë me prokurimin publik në Kosovë.

Mirëpo KRPP është përballur me ngecje të mëdha sa i përket mbikëqyrjes së zbatimit të kontratave publike. Si pasojë e kësaj, KRPP në këtë vit e ka lënë të bardhë "listën e zezë", e cila do të shërbente si masë e parandalimit të dëmtimit të buxhetit të Kosovës nga ana e kontraktorëve të papërgjegjshëm në realizimin e kontratave. Institucioni që për mandat ka mbikëqyrjen

53 Organi Shqyrtues i Prokurimit (2011). Raporti Vjetor i Punës 2010. Prishtinë. [http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/raporti\\_shqip\\_2010\\_online.pdf](http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/raporti_shqip_2010_online.pdf)

54 Gjatë vitit 2010, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka trajtuar 430 ankesa të parashtruara nga ana e operatorëve ekonomik kundër vendimeve të Autoriteteve Kontraktuese për dhënie të kontratës, pa i llogaritur 155 ankesat e autoriteteve kontraktuese për rishqyrtim të vendimeve të APP-së, nga 430 ankesat e operatorëve ekonomik të pakënaqura me vendimet e institucioneve për dhënie të tenderëve, 84 tenderë kanë shkuar në rivlerësim, 62 janë anuluar për t'ia nisur procedurave nga fillimi, kurse 87 janë renditur në listën e tenderëve të "flakur". Klasifikimi i ankesave në bazë të vlerës: ankesa me vlerë të madhe në total prej 77.086.424,63 euro; ankesa me vlerë të mesme në total prej 11.310.280,61 euro; ankesa me vlerë të vogël në total prej 450.994,10 euro.

55 Në artikullin "Prokurimi s'i besoi ofertës më të lirë", i botuar me 09 gusht 2011, në të përditshmen Koha Ditore trajtohet një rast ku "OSHP pritet të akuzohet nga kompania private e sigurimit "Syri Group" se ka bërë shkelje ligjore me rastin e kthimit në rivlerësim të aktivitetit të prokurimit për sigurimin fizik të objekteve të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Pronari i kompanisë "Syri Group", e cila ishte shpallur fituese nga Ministria e Punës, thotë se do t'i drejtohet EULEX-it, Agjencisë Kundër Korrupsion dhe Gjykatës Supreme rreth një vendimi të OSHP-së, pasi nuk është respektuar kriteri i dhënies së kontratës që ka qenë "çmimi më i ulët". <http://www.kohaditore.com/index.php?page=1,3,65520>

56 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – KRPP (2011). Raporti mbi aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë për vitin 2010. Prishtinë. <http://krpp.rks.gov.net/krpp/PageFiles/File/Raportet%20vjetore%202006%202007%202008/Shqip%20Raportit%20KRPP%202010%2001%2003%202011.pdf>

57 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (2011). Raporti vjetor i auditimit 2010. Përmbledhja e Përgjithshme. Prishtinë. <http://oag.rks-gov.net/Raportet%20shqip/BKK/KCB2009alb.pdf>

e realizimit të kontratave publike, sipas raportit të Auditorit të Përgjithshëm vet ka bërë shkelje pikërisht në fazën e realizimit të kontratave me kontraktorët e këtij institucioni. Shkeljet që ka evidentuar ZAP në këtë institucion kanë të bëjnë me pagesa të faturave në mungesë të dëshmive, mospërputhje të sasisë së vlerësuar për furnizim me nevojat reale dhe shmangia nga procedura adekuate të prokurimit<sup>58</sup>.

Raporti final i auditimit të prokurimit për vitin 2010, i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP)<sup>59</sup>, dëshmon për progresin e ngadalhtë dhe nivelin e lartë të shkeljeve ligjore dhe keqpërdorimeve të institucioneve publike gjatë realizimit të procedurave të prokurimit dhe zbatimit të kontratave publike. Sipas të dhënave të këtij raporti kontrollat menaxheriale mbi proceset, aktivitetet që nga faza e planifikimit e deri të vlerësimit i ofertave dhe vendimet e prokurimit nuk janë aplikuar në mënyrë të shpeshtë. Procesit të prokurimit duhet ti kushtohet më shumë vëmendje nga ana e menaxhmentit si në fazën e planifikimit ashtu edhe në atë të ekzekutimit. Gjithashtu sipas te njejtij raport të ZAP, institucionet qendrore nuk kanë marrë masat e mjaftueshme sa i përket monitorimit dhe kontrollit të procesit të prokurimit, transparencës dhe konkurrencës së barabartë për të gjithë Operatorët Ekonomik (OE) si dhe vlerësimin e drejtë të ofertave bazuar në kërkesat e përcaktuara, zhvillimin e mëtejme të funksionit të mbikëqyrjes për realizimin e projekteve për të siguruar funksionimin më të mirë të sistemit të prokurimit.

Sipas raportit të Freedom House të publikuar në vitin 2010, procedurat e prokurimit dhe tenderimit në Kosovë, nuk janë transparente<sup>60</sup>. Këtë e dëshmon mos

përfshirja e rekomandimeve të shoqërisë civile nga ana e institucioneve të Kosovës sa i përket dispozitave të transparencës në ligjin e prokurimit publik Nr. 04/L-042, të dekretuar me 31 gusht 2011. Gjithashtu në këtë kontekst nëse merren si shembull procedurat e prokurimit për autostradën Morinë-Merdare, si një nga projektet më të mëdha kapitale, afëherë shihet se disa nga parimet bazë të transparencës nuk janë respektuar, siç është informimi i publikut gjatë planifikimit të projektit dhe procedurave të prokurimit, refuzimi i kërkesave të shoqërisë civile për qasje në dokumentacionin e projektit si dhe tendenca për anashkalimin e institucioneve mbikëqyrëse<sup>61</sup>. Insistimi i institucioneve të Kosovës, që më tutje procedurat e prokurimit publik dhe menaxhimi i fondeve publike të jenë procese të izoluara për publikun bien ndesh me nenin 120 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili garanton transparencë, llogaridhënie dhe efektivitet në shpenzimin e parasë publike<sup>62</sup>.

## **2.7 Lufta (me fjalë) Kundër Korrupsionit**

Institucionet e Republikës së Kosovës nuk kanë treguar vullnetin në raport më nivelin e lartë të aferave korruptive. Përgjatë kësaj periudhe kohore është bërë amandamentimi, ndryshimi dhe plotësimi i legjislacionit anti-korrupsion. Megjithatë, paketa e tillë ligjore vazhdon edhe më tutje të mos jetë tërësisht në përputhje me standardet dhe praktikat ndërkombëtare. Deklarimi i pasurisë nga ana e zyrtarëve të lartë publikë tek Agjencia Kundër Korrupsionit përmban të dhëna të pasakta dhe është në shpërputhje me deklaratat e pasurisë të dërguara tek Komisioni Qendror Zgjedhor. Kjo përbën shqetësim të madh për nivelin e lartë të korrupsionit dhe shtrirjes së gjerë

58 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (2011). Raporti i auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2010. Nr. i dokumentit: 24.34.1-2010-08. Prishtinë. [http://oag.rks-gov.net/Raportet%20shqip/2010/Agjencio-net/2010\\_KRPP\\_Raporti\\_Auditimit\\_Shq.pdf](http://oag.rks-gov.net/Raportet%20shqip/2010/Agjencio-net/2010_KRPP_Raporti_Auditimit_Shq.pdf)

59 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (2011). Raporti vjetor i auditimit 2010. Auditimet e ZAP-it në prokurim për vitin 2010. Prishtinë. <http://oag.rks-gov.net/Raportet%20shqip/BKK/KCB2009alb.pdf>

60 Freedom House (2011). Nations in Transit 2010: Kosovo. Corruption. <http://www.freedomhouse.org/images/File/>

[nit/2010/NIT-2010-Kosovo-final.pdf](http://www.nit/2010/NIT-2010-Kosovo-final.pdf)

61 Lëvizja FOL (2010). Transparenca e investimeve publike në infrastrukturën rrugore. Prishtinë. [http://www.levizjafol.org/images/uploads/files/Transparenca\\_e\\_investimeve\\_publike\\_n%C3%AB\\_infrastruktur%C3%ABn\\_rrugore1112.pdf](http://www.levizjafol.org/images/uploads/files/Transparenca_e_investimeve_publike_n%C3%AB_infrastruktur%C3%ABn_rrugore1112.pdf)

62 Kuvendi i Republikës së Kosovës (2008). Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Kapitulli IX Marrëdhëniet Ekonomike - Neni 120 Financat Publike. Prishtinë. [http://www.kuven-dikosoves.org/common/docs/Kushtetuta\\_sh.pdf](http://www.kuven-dikosoves.org/common/docs/Kushtetuta_sh.pdf)

të tij në institucionet publike të vendit. Po ashtu, institucionet e vendit kanë shfaqur fare pak vullnet për luftimin e korrupsionit, duke u treguar tejet pasive në ndërmarrjen e veprimeve konkrete për minimizimin e shkallës së lartë të korrupsionit.

Qeveria e Kosovës ka realizuar disa ndryshime në pakon e ligjeve anit-korrupsion, por që perceptimi, dhe raportet e ndryshme si: Raportet e Auditorit të Përgjithshëm shprehin qartë nivelin e lartë të korrupsionit në shumë ministri. Përgjatë kësaj periudhe kohore qeveria ka përkrahur kërkesën e Prokurorisë Speciale të Kosovës për kompensimin e shtesave dhe stimulimin financiar për punonjësit e saj, ka themeluar Njësinë për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Zbatimin e Ligjit, si dhe ka miratuar projekt-ligjet antikorrupsion që burojnë nga Strategjia Legjislative për vitin 2011. Megjithatë, këto aktivitete kanë qenë të pamjaftueshme për ta reduktuar nivelin e lartë të korrupsionit dhe shtrirjen e gjerë të tij në institucionet publike. Dhënia e tenderëve në mënyrë të parregullt, keqpërdorimi i autoritetit zyrtar dhe abuzimi me paranë publike janë vetëm disa nga aferat korruptive që janë duke vazhduar ta shoqërojnë Qeverinë e Kosovës.

Sistemi Gjyqësor ka tentuar të tregoj pavarësinë e funksionimit të tij, dhe në disa raste ka shprehur vullnet në luftë kundër korrupsionit, por ka qenë nën-pretjet e opinionit publik dhe obligimeve ligjore dhe kushtetuese. Numri i lëndëve të pazgjydhura që kanë të bëjnë me shpërdorim të detyrës zyrtare, marrje të rryshfetit dhe dhënie të rryshfetit është vazhdimisht në rritje. Pikërisht mos-zgjidhja e këtyre lëndëve është duke treguar nivelin e dobët të funksionimit të Gjyqësorit të Kosovës. Në këtë drejtim, duhet të rritet domosdoshmërisht numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve në fushën anti-korrupsion. Megjithatë, ka disa lëvizje pozitive nga ana e Prokurorisë (në nivel qarku dhe komuna) në ngritjen e akt-akuzave dhe propozim-akuzave. Përpjekjet për reformimin e këtij pushteti kanë vazhduar edhe gjatë këtij viti.

Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK)

ka shprehur angazhim mjaft të qartë në relacion me luftën kundër korrupsionit. Gjatë tërë vitit ka pranuar informata nga qytetarë dhe zyrtarë të ndryshëm në lidhje me afera korruptive në institucionet publike, ka denoncuar praktika abuzive, ka dërguar në Prokurori informata rreth zyrtarëve të implikuar në afera korruptive, si dhe suksesshëm ka përmblyllur procesin e deklarimit të pasurisë nga ana e zyrtarëve të lartë publikë. Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) gjatë kësaj periudhe kohore ka qenë e përqendruar tek procesi i deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, tek publikimi i Raportit Vjetor 2010 dhe te miratimi i tij në Kuvendin e Kosovës. Më shumë se 95 % e zyrtarëve të lartë publikë e kanë deklaruar pasurinë e tyre tek Agjencia kundër Korrupsionit. Sipas Ligjit mbi Deklarimin, Kontrollin dhe Prejardhjen e Pasurisë numri i zyrtarëve të lartë publik të cilët kanë pasur për obligim ta bëjnë deklarimin e pasurisë së tyre tek Agjencia kundër Korrupsionit ka qenë 1830. Nga ky numër i tërësishëm obligimin ligjor e kanë përmbushur 1746 ose 95.40%. Numri i atyre që nuk e kanë deklaruar pasurinë është 84 zyrtarë apo 4.60%, ndërsa 26 zyrtarë të tjerë e kanë deklaruar pasurinë e tyre por që në fakt formulari nuk është i plotësuar konform ligjit dhe standardeve/kritereve të cilat i ka përcaktuar AKK-ja.

Agjencia duhet të fuqizohet edhe më shumë, sepse roli dhe funksioni i saj është reduktuar vetëm në hetime administrative. Ana negative e AKK-së është treguar në drejtim të Konfliktit të Interesit. Shumë zyrtarë të përfshirë në konflikt të interesit janë shfajësuar nga ana e AKK-së, duke u krijuar komoditetin këtyre zyrtarëve të mbajnë shumë funksione publike.

Gjithashtu mangësi e Ligjit mbi Deklarimin, Kontrollin dhe Prejardhjen e Pasurisë mbetet fakti që deklarimi i rrejshëm dënohet shumë butë<sup>63</sup>, prej 150 deri në 1500 euro. Është kërkesë e shoqërisë civile por edhe e AKK që deklarimi i

<sup>63</sup> Dënimet për zyrtarët që bëjnë deklarim të rrejshëm variojnë prej 150 deri në 1500 euro që është dënim shumë i butë për zyrtarë që mund të fshehin pasuri në shuma shumëfish më të larta.

rrejtshëm të futet në Kodin Penal të Kosovës si vepër penale. E meta e dytë, e këtij ligji është që nuk mundëson rënien në gjurmë të prejardhjes së pasurisë së zyrtarëve të lartë. Ata mund ta deklarojnë pasurinë sipas dëshirës së tyre pa pasur frikë se dikush do ta hetojë prejardhjen e saj.

Policia e Kosovës (PK) përgjatë kësaj periudhe ka treguar përkushtim në luftën kundër korrupsionit, por, po ashtu, edhe ky institucion mbetet peng e institucioneve tjera, gjë që zbeh shumë angazhimet anti-korrupsion. Ka pasur më shumë përpjekje për fuqizimin e luftës kundër korrupsion: duke realizuar hetime rreth aferave korruptive, arrestime të zyrtarëve publikë, si dhe duke dërguar njashtu informata në Prokurorinë e Kosovës. Megjithatë, ende praktikat e shpërdorimit të detyrës zyrtare, marrjes së rryshfetit, përvetësimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare dhe dhënies së rryshfetit vazhdojnë të jenë pjesë e këtij institucioni.

Doganat e Kosovës (DK) edhe përkundër faktit që për një kohë kanë qene objekt i hetimeve, ky institucion ka reaguar ndaj disa rasteve me afere korruptive, por që sigurisht nuk kanë qentë të mjaftueshëm. Angazhimet e këtij institucioni kanë qenë në kontekst të hapjes dhe transparencës. Çdo herë kur janë paraqitur praktika abuzive janë marrë hapa të menjëhershëm për ndëshkimin e zyrtarëve të përfshirë në këto afere korruptive. Së fundmi është zvogëluar numri i rasteve me afere korruptive.

## 2.8 Sektori i sigurisë

Krahasuar me vitin e kaluar, sektori i sigurisë ka shënuar progres megjithatë janë vërejtur dobësi në konsolidimin e institucioneve. Në këtë periudhë kohore, janë miratuar disa ligje të rëndësishme, siç janë Ligji për Sigurinë Private, Ligji për Inspektoriatin Policor, Ligji për pajisje me armë, etj. Mirëpo një pjesë ende ka mbetur në procedurë apo janë në fazën fillestare të hartimit. Sikurse në sfera tjera, problem mbetet implementimi i ulët i ligjeve në sferën e sigurisë. Në përgjithësi, ka pasur një ritëm të ngadaltë të hartimit

dhe miratimit të legjislacionit në sferën e emergjencave civile dhe nuk është identifikuar ndonjë progres në ngritjen e kapaciteteve të menaxhimit të emergjencave civile në Kosovë.

Këtë vit është konsoliduar Agjensioni Shtetëror për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Mirëpo, ende nuk është operacionalizuar Departamenti për Verifikimin e Besueshmërisë, në të cilën do të fillonte ndërtimi i sistemit shtetëror për klasifikimin e informacioneve. Këshillat Komunale të Sigurisë në Bashkësi kanë vazhduar së funksionalizuar dhe është hartuar Strategjia për siguri në bashkësi.<sup>64</sup> Qëndrueshmëria e tyre vihet në pikëpyetje si rezultat i mungesës së kapaciteteve, mbështetjes së vogël nga kryetarët e komunave (si kryesues të këtij forumi) dhe krijimit të mekanizmave me role të ngjashme nga donatorët.

### Policia e Kosovës

Policia mbetet institucioni më tepër i konsoliduar në raport me institucionet e tjera të sigurisë.<sup>65</sup> Tashmë, është në proces hartimi i ligjit të ri për policinë i cili pritet të reflektoj reformimin e këtij institucioni dhe përshtatjen konform rrethanave të reja. Megjithatë, është vërtetuar se ndryshimet e shumta dhe të shpeshta në pozitat menaxhuese në polici prishin koherencën në procesin e reformimit të institucioni. Për më shumë, krahas problemeve subjektive, policia përballlet me mungesë të kapaciteteve teknike e rrjedhimisht mbetet në varësi operacionale ndaj institucioneve ndërkombëtare për zbatimin e ligjit – KFOR-it dhe EULEX-it. Si rezultat i kësaj gjendje, policia privohet nga ushtrimi dhe ekzekutimi i misionit dhe realizimit të objektivave në fushën e luftimit të krimit të organizuar, terrorizmit por edhe mbajtjes e vendosjes së rendit publik, veçanërisht në situata të ballafaqimit me trazirat eventuale. Policia ende mbështetet në 3 autoblanda të blera në vitin 2010 dhe, për më tepër, është

<sup>64</sup> MPB, Strategjia nacionale dhe plani i veprimt për sigurinë në bashkësi, Qershor, 2011

<sup>65</sup> QKSS, Analiza kontekstuale për reformimin e sektorit të sigurisë në Kosovë, Mars 2011

e vetmja polici në rajon që nuk ka kapacitete të vëzhgimit dhe kontrollit nga ajri të zonës kufitare, trafikut, trazirave, situatave emergjente por edhe për transportimin e njësiteve të specializuara në zonat ku kërkohet intervenimi i tyre.<sup>66</sup> Menaxhimi i flotës të automjeteve ekzistuese është një ndër dobësitë bazë që ndikojnë në efektivitetin e policisë për shkak të mungesës së ekspertizës së domosdoshme për mirëmbajtjen e tipeve dhe modeleve të ndryshme të automjeteve me të cilat operon policia.

Policia vazhdon t'iu nënshtrohet implikimeve politike që bazohet në ndryshimet e shpeshëta të menaxhimentit e më këtë ky institucion vlerësohet të jetë ndarë në grupe dhe në interes të akterëve të caktuar. Marrëdhëniet me EULEX-in kanë shënuar rënie si rezultat i ngjarjeve në veri dhe qëndrimeve të hapura të Ministrit Rexhepi për moskryerjen e detyrave dhe misionit nga EULEX-i. Mos-pjesëmarrja në iniciativat policore rajonale e ndërkombëtare (siç janë SECI Centre, EUROPOL, INTERPOL, Police Convention dhe mekanizmat tjerë rajonal) për shkaqe politike po reflektohet në vet përmbushjen e misionit të policisë, por edhe forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar si nevojë për të luftuar dhe ballafaquar me sfidat e sigurisë ndërkombëtare.

Policia edhe më tutje vazhdon të ketë nivel më të kënaqshëm në qeverisjen e mirë dhe se, në krahasim me institucionet tjera, ka treguar rezultate sa i përket transparencës dhe përfshirjes etnike e gjinore.<sup>67</sup> Raporti i Auditorit të Përgjithshëm ka identifikuar shumë parregullsi në menaxhimin e parasë publike në MPB e Polici.<sup>68</sup>

Policia kufitare ka përmbyllur procesin e marrjes së kontrollit të vijës së gjelbër kufitare me Malin e Zi mirëpo ende nuk

është e sigurt nëse e njëjta gjë së shpejti do të ndodh edhe në kufirin me Serbinë. Për të arritur një gjë të tillë, krahas tejkalimit të problemeve politike kjo varet edhe nga nevoja e shtimit numrit të policëve kufitar dha pajisjes së tyre në mënyrë adekuate.<sup>69</sup> Problem në vete paraqet edhe mungesa e demarkacionit të kufijve me të gjitha shtetet fqinje, përveç Maqedonisë.

#### Forca e Sigurisë së Kosovës

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) ka vazhduar zhvillimin e saj ku sipas të dhënave të muajit Qershor 2011, janë rekrutuar përafërsisht 2.300 pjesëtarë aktiv duke e finalizuar gati tërësisht procesin e rekrutimit në komponentën aktive.<sup>70</sup> Megjithatë, pavarësisht miratimit të ligjit për komponentën rezervë, ka ngecje në trajnimin dhe funksionalizimin e rezervistëve të cilët parashihet të jenë 800 pjesëtarë. Hulumtimet gjatë kësaj periudhe raportuese kanë identifikuar dobësi të shumta në procesin e përzgjedhjes së pjesëtarëve të FSK-së, në bazë të preferencave grupore, rajonale e politike.<sup>71</sup> Në përgjithësi, ka diskrepancë mes deklarimeve të kreut të FSK-së për arritjen e kapaciteteve të plota operationale në njërin anë, dhe dobësive subjektive e teknike në anën tjetër.

FSK gjatë këtij viti ka arritur të furnizohet pjesërisht me armë të lehta mirëpo ende është larg kompletimit në aspektin teknik. Pronësia vendore vazhdon të mbetet problem në FSK si rezultat i varësisë së madhe ndaj pranisë ndërkombëtare. Megjithatë pjesëmarrja e një njësi të FSK-së me rastin e ndërrimit të komandës së KFOR-it është një hap para drejt avancimit dhe pavarësisht të këtij institucioni.

FSK nuk ka zhvilluar sa duhet komponentën e qeverisjes së mirë; në veçanti reflekton një institucion jo-transparent ku ka ndërtuar një kulturë të mbylljes. FSK, ngjashëm sikur policia,

<sup>66</sup> Policia nuk ka helikopter vëzhgues dhe as transportues që të shërbente për këtë funksion

<sup>67</sup> Progresi i policisë në aspektet e qeverisjes së mirë është identifikuar në hulumtimet në progres të QKSS lidhur me zhvillimin e qeverisjes dhe mbikqyrjes demokratike të institucioneve të sigurisë.

<sup>68</sup> ZAGJ, Raporti i Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të MPB për vitin 2010, Qershor 2011

<sup>69</sup> Forumi i Sigurisë, Menaxhimi i integruar i kufirit, Dhjetor 2010

<sup>70</sup> Forumi i Sigurisë, Forca e Sigurisë së Kosovës – në mes sfidave aktuale dhe vizionit për të ardhmen, Qershor 2011

<sup>71</sup> Ibid 70.

vazhdon te ketë vështirësi në pjesëmarrje në konferencat dhe aktivitetet e përbashkëta rajonale. Mirëpo, edhe pse Ministria e FSK-së pretendon për pjesëmarrje në disa aktivitete, ato janë të pakta në krahasim me numrin e iniciativave ekzistuese në rajon, Evropë e më gjerë. Raporti i Auditorit për vitin 2010 ka gjetur dobësi në menaxhimin e financave publike (e sidomos në procesin e rekrutimit, furnizimin dhe kontrollin e brendshëm) por ka përmirësim në krahasim me vitet paraprake.<sup>72</sup>

#### Agjencioni për Inteligjencë i Kosovës (AKI)

AKI ka vazhduar së funksionalizuar dhe është raportuar për një numër respektabil të rekrutuar dhe trajnuar në periudhën raportuese. Megjithatë, mungesa e transparencës në AKI dhe vështirësitë e mediave dhe shoqërisë civile për qasje në punën e këtij institucioni priron një konkludim të saktë lidhur me ngritjen e AKI.<sup>73</sup> Komisioni parlamentar për mbikëqyrjen e AKI udhëhiqet nga opozita dhe debatet e vazhdueshme brenda reflektojnë një atmosferë demokratike. Megjithëse fokusi disa-mujor në çështjen e shërbimeve inteligjente partiake e ka larguar vëmendjen e komisionit në kryerjen e mandatit të saj – mbikëqyrjen e AKI.

### **2.9 Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve**

#### Ligjet Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Njeriut të zbatueshme në Kosovë dhe respektimi i tyre

Kushtetuta e Republikës së Kosovës<sup>74</sup> parasheh zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare e cila thekson tetë konventa të njohura ndërkombëtarisht mbi të drejtat e njeriut<sup>75</sup> dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës

72 ZAGJ, Raporti i Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të MFSK për vitin 2010, Qershor 2011

73 P.sh AKI ende nuk ka lansuar ëeb-faqen e që studiuesit do të kishin qasje në burimet e hapura. Jo-transparent mbetet edhe puna e Komisionit për Mbikëqyrjen e AKI

74 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22.

75 Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut; Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Drejtave Themelore dhe Protokollet e saj; Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollet e saj; Kon-

Evropiane për të Drejtat e Njeriut<sup>76</sup>. Prandaj, dispozita të tilla ligjore i japin mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës një themel shumë të fortë, gjë që duhet të zbatohet në praktikë nga të gjitha institucionet udhëheqëse në Kosovë, e sidomos nga gjyqësori.

Megjithatë, vitin e fundit ka pasur pak progres sa i përket promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Problem kyç mbetet se vetë garantuesit e të drejtave të tilla themelore zakonisht janë dhe shkelësit e tyre. Në vitin 2010, numri më i lartë i shkeljeve të pohuara të të drejtave të njeriut në Kosovë janë bërë nga sistemi gjyqësor, i cili vazhdon të jetë joefektiv, si dhe nga Ministrinë, Komunat dhe Ndërmarrjet Publike të Republikës së Kosovës<sup>77</sup>.

#### Masat Ligjore Kombëtare

Kuvendi i Kosovës ka vijuar të miratojë një sërë masash ligjore. Për shembull, Ligji i amandamentuar mbi Qasjen në Dokumentet Publike<sup>78</sup> ka hyrë në fuqi në këtë periudhë për të cilën raportohet. Edhe pse kjo copëz e legjislacionit është kyçe sa i përket fuqizimit të së drejtës ndaj informacionit publik si një e drejtë themelore e njeriut në Kosovë, mungon zbatimi i tij dhe hulumtimet dëshmojnë se në praktikë, nuk ka pasur asnjë progres<sup>79</sup>. Po ashtu, është miratuar dhe Ligji i Punës<sup>80</sup>, mirëpo shkalla në të cilën ai përputhet me Ligjin Kundër Diskriminimit mbetet e diskutueshme<sup>81</sup>. Ndërkohë, Ligji Kundër

venta Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor; Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave; Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës; Konventa kundër Torturës dhe Trajtitimit apo Dënimit Tjetër Mizor, Çnjerëzor dhe Degradues gjenden në <http://www.kushtetutakosoves.info/repository/docs/Constitution.of.the.Republic.of.Kosovo.pdf> f. 6 lexuar më 15/09/2011

76 Neni 53

77 Institucioni i Ombudspersonit të Republikës së Kosovës, 'Raporti i Dhjetë Vjetor 2010', Prishtinë, korrik 2011, në f. 19 para. 3

78 Ligji Nr.03/L -21

79 Analizë Politike e GAP, 'Zbatimi i Ligjit mbi Qasjen në Dokumente Publike – gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi' maj 2011, në f. 1 dhe 19 që gjendet në <http://www.institutigap.org/repository/docs/QasjaDokumentePublike2.pdf> lexuar më 17/09/2011

80 Ligji Nr.03/L -212 miratuar më 1 nëntor 2010

81 Kjo do të trajtohet më me hollësi në seksionin mbi të Drejtat e Grave



Diskriminimit<sup>82</sup> përballet gjithashtu me zbatim joefektiv.

#### Liria e shprehjes

Edhe pse janë marrë masa për të shuar mospërputhjet mes Ligjit mbi Shpifjen dhe Fyerjen<sup>83</sup> dhe Kodit Penal të Kosovës, amendamentimet duhet të miratohen urgjentisht. Megjithëse raportet shpallin mjedis të përmirësuar të lirisë së shprehjes,<sup>84</sup> gazetaret vazhdojnë të përballen me kufizime në raportimin e tyre. Rastet e frikësimit, abuzimit, ngacmimit<sup>85</sup> të gazetarëve, madje dhe sulmet fizike<sup>86</sup> kanë vazhduar. Akte të tilla nuk janë dënuar fuqimisht nga institucionet kosovare dhe ka pasur raste kur janë kryer nga zyrtarë të qeverisë. Për më tepër, Qeveria vazhdon të ruajë rolin e saj dominues në media që e mban përmes reklamimit, të cilin e përdor si mjet për kontrolluar informacionin. Gjithashtu, pavarësia dhe paanshmëria e RTK-së është një çështje që ende nuk është adresuar<sup>87</sup>.

#### Liria fetare

Në përgjithësi, liria fetare respektohet përmes instrumenteve ligjore. Mirëpo, korniza ligjore për regjistrimin e komuniteteve fetare ende nuk është miratuar, pra ndonjëherë komunitetet fetare pengohen të gëzojnë të drejtat e tyre të plota. Gjithashtu, e drejta për lirinë fetare është politizuar së tepërmi dhe është shtrirë në akte brenda qeverisë, që mund të argumentohet se nuk janë brenda ligjit<sup>88</sup>.

82 Ligji Nr.2004/ 3 miratuar më 19 shkurt 2004 hyrë në fuqi më 19 shtator 2004

83 Ligji Nr. 02/L-65 miratuar më 15 qershor 2006

84 Vlerësuar me 2.70, më i larti që nga viti 2001, Indeksi mbi Qëndrueshmërinë e Medias Kosovare 2011 që gjendet në <http://www.irex.org/resource/kosovo-media-sustainability-index-msi> lexuar më 17/09/2011

85 Departamenti i Shtetit SHBA, '2010 Raporti mbi të Drejtat e Njeriut: Kosova', 8 prill 2011, në f. 17-20 që gjendet në <http://www.state.gov/g/drl/rls/hrrpt/2010/eur/154432.htm> lexuar më 17/09/2011

86 Jutullemi shikoni <http://ks.yihr.org/ks/article/79/> dhe <http://ks.yihr.org/ks/article/78/Condemn-of-the-attack-on-Klan-Kosovas-journalist> lexuar më 17/09/2011

87 Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë, 'Tkurria e Hapësirës Publike? Qeverisja dhe Shprehja e Lirë në Kosovë', 24 maj 2010, që gjendet në [ks.yihr.org/en/article/8/State-of-Constriction-report](http://ks.yihr.org/en/article/8/State-of-Constriction-report) lexuar më 27/09/2011

88 Departamenti i Shtetit SHBA, korrik-dhjetor, 2010 Raporti mbi Lirinë Fetare Ndërkombëtare - Kosova, 13 shtator 2011, që gjendet në: <http://www.unhcr.org/refworld/>

#### Liria e lëvizjes

Kjo është e drejtë e garantuar dhe përgjithësisht e realizuar në praktikë, megjithatë ekzistojnë disa zona në Kosovë, ku minoritetet vazhdojnë të përballen me pengesa në realizimin e lëvizjes së lirë. Domethënie të posaçme ka situata e minoriteteve<sup>89</sup> në disa enklava sikurse Zubin Potoku, Pasjani, Ropotova, Leposaviçi që citojnë sigurinë si arsyen kryesore për mosrealizimin e kësaj të drejte<sup>90</sup>. Gjithashtu, gjendja aktuale në veri të Kosovës vazhdon të pengojë realizimin e kësaj të drejte për të gjithë qytetarët, pavarësisht etnisë së tyre.

#### Liria e anëtarësimit

Me amendamentimin e Ligjit mbi Lirinë e Anëtarësimit në Organizata Jo-Qeveritare është arritur disa progres. Megjithatë, pa akte të tjera legjislative lidhur me komunitetet fetare dhe ndërmarrjet, vihet në pikëpyetje nëse ky ligj do zbatohet në mënyrë efektive. Gjithashtu, nuk mund të raportohet progres lidhur me shfrytëzimin e ekspertizës së shoqërisë civile nga ana e Qeverisë. Edhe pse OJQ-të kanë punuar drejt ngritjes së kapaciteteve, ekziston hapësirë për përmirësim të mëtejshëm në një sërë aspektesh, përfshirë: bashkëpunimin, ngritjen e vetëdijesimit publik dhe mekanizmave monitorues.

#### **Të drejtat e minoriteteve**

##### Përdorimi i gjuhëve

Ligji mbi Përdorimin e Gjuhëve<sup>91</sup> është miratuar në vitin 2006; në periudhën e fundit të përfshirë nga raporti është raportuar progres sa i përket zbatimit të tij në gjyqësor dhe në vitin 2009, Komisioni për Gjuhë ka dhënë edhe rekomandime të tjera<sup>92</sup>. Mirëpo, në këtë periudhë mund të raportohet pak progres pasi që kapaciteti i institucioneve për të zbatuar me efektivitet ligjin e

<http://ks.yihr.org/ks/article/79/> dhe <http://ks.yihr.org/ks/article/78/Condemn-of-the-attack-on-Klan-Kosovas-journalist> lexuar më 17/09/2011

89 Përfshin serbë dhe RAE

90 Kjo është bazuar në punën e Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë gjatë tri viteve të kaluara në kuadër të projektit të "Vizitave brenda Kosovës"

91 Ligji Nr. 02/L-37 miratuar më 27 korrik 2006

92 Komisioni për Gjuhë, Zyra e Kryeministrit, Raporti Vjetor 2009 që gjendet në <http://www.ks-gov.net/kgjz/HomeL.aspx?id=21&t=1> lexuar më 18/09/2011

lartpërmendur nuk është përmirësuar. Për më tepër, publiku nuk di aspak për punën e Komisionit. Prandaj, pavarësisht faktit se ligji është në fuqi që prej pesë vitesh, implementimi dhe ekzekutimi nuk janë të tërësishme dhe diskriminimi vazhdon.

#### Roma, Ashkali, Egjiptian

Komunitetet RAE vazhdojnë të përballen me marginalizim dhe diskriminim sa i përket qasjes në arsim, kujdes shëndetësor, punësim dhe mbrojtje sociale. Sa i përket arsimit, nuk ekziston asnjë sistem universal për mbledhjen e të dhënave mbi nxënësit nga minoritetet, gjë që e vështirëson konstatimin e numrit të këtyre fëmijëve që nuk mund t'a realizojnë të drejtën e tyre, sidomos atë të nivelit obligativ për arsye të ndryshme. Ata fëmijë që nuk ndjekin shkollën vazhdojnë të izoloohen<sup>93</sup>. Për më tepër, për pakicat mbetet e vështirë qasja në shërbimet shëndetësore, e cila është praktikë diskriminuese nga autoritetet.

Ky marginalizim dhe diskriminim përkeqësohet dhe më tej nga presioni i riatdhesisimit të pakicave të tilla nga vendet perëndimore, që është vazhduar pavarësisht thirrjeve për ndërprerje të kësaj praktike nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Komisioneri për të Drejtat e Njeriut i Këshillit të Evropës dhe një sërë OJQ-sh<sup>94</sup>. Kryesisht, kjo ndodh pasi kthimi i tyre i bën ata posaçërisht të cenueshëm ndaj abuzimit të të drejtave të njeriut. Është e qartë se këtu luhen konsiderata politike, mirëpo duhet të kemi parasysh se edhe detyrimet ligjore janë po aq të rëndësishme, për të mos thënë më shumë të rëndësishme dhe këto nuk realizohen vetëm me planifikim të vazhdueshëm dhe fare pak veprim apo veprime ad hoc.

93 Qendra Europiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë, 'Mbrojtja dhe Promovimi i Arsimit për Komunitetet Minoritet – Doracak për zyrtarë komunal', Prishtinë, mars 2010, f. 8 dhe 38 që gjendet në <http://www.ecmikosovo.org/fileadmin/ecmikosovo.tpl/pdf/10ManualMinorityEducation.pdf> lexuar më 18/09/2011

94 Human Rights Watch, 'Ballkani duhet të hapë qasjen ndaj të drejtave të njeriut – kthimi me detyrim në Kosovë', 28 shkurt 2011, që gjendet në <http://www.hrw.org/news/2011/02/28/balkans-must-broaden-approach-human-rights> accessed on 17/09/2011

Amnesty International, 'Nuk mirëpritën askund – ndal kthimin e detyrueshëm të romëve në Kosovë', shtator 2010, që gjendet në [http://www.amnesty.org.uk/uploads/documents/doc\\_20747.pdf](http://www.amnesty.org.uk/uploads/documents/doc_20747.pdf) lexuar më 18/09/2011

#### Të drejtat e grave

Gjatë kësaj periudhe për të cilën raportohet, të drejtat e grave kanë vazhduar të cenohen në një sërë fushash.

Edhe pse përdhunimi është vepër penale, përdhunimi në martesë mbetet çështje e paadresuar. Është raportuar se shumë raste përdhunimesh në shoqërinë kosovare nuk paraqiten për shkak të stigmës sociale që i përcjell, si një nga arsytet e tjera<sup>95</sup>. Mirëpo, për shkak të qëndrimit aktual ligjor sa i përket përdhunimit në martesë, edhe më pak raste raportohen. Po ashtu, edhe viktimat e ngacmimit seksual, shumica e të cilave janë gra, nuk kanë mbrojtje ligjore pasi nuk ka akte ligjore specifike që penalizojnë një sjellje të tillë. Edhe pse Ligji Kundër Diskriminimit<sup>96</sup>, Neni 2(a), e njeh ngacmimin si formë të sjelljes diskriminuese, në këndvështrimin e pozitës së grave në shoqërinë kosovare, kjo nuk është e mjaftueshme. Duhet ofruar mbrojtje më e mirë.

Dhuna familjare vazhdon të ekzistojë si një problem që kryesisht prek gratë, që gjatë periudhës për të cilën raportohet ka rezultuar në humbje jete. Edhe pse ekziston kornizë ligjore kryesisht përmes Ligjit mbi Mbrojtjen Kundër Dhunës Familjare<sup>97</sup>, dhuna familjare është pranuar si formë e diskriminimit<sup>98</sup>, që është direkt e zbatueshme në Kosovë<sup>99</sup> dhe zbatimi i tij është i pakënaqshëm.

Gratë vazhdojnë të përballen me diskriminim në vendin e punës, pavarësisht Ligjit të Punës të sapomiruar<sup>100</sup>. Edhe pse dispozita mbi pushimin e lindjes është konsideruar si tejet me përfitim për gratë, në praktikë zbatimi i saj pengohet nga buxheti i ulët i Qeverisë dhe anashkalimi i ligjit nga ana e punonjësve përmes

95 Departamenti i Shtetit SHBA, '2010 Raporti për të Drejtat e Njeriut: Kosova', 8 prill 2011, në f. 17-20 që gjendet në <http://www.state.gov/g/drl/rls/hrrpt/2010/eur/154432.htm> lexuar më 18/09/2011

96 Ligji Nr.2004/3 miratuar më 19 shkurt 2004, hyrë në fuqi më 19 shtator 2004

97 Ligji Nr.03/L –182 miratuar më 1 korrik 2010

98 Opuz kundër Turkey [GC], nr. 33401/02, KEDNJ 2009

99 Neni 53 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës

100 Ligji Nr.03/L –21 miratuar më 2 nëntor 2010, hyrë në fuqi më 16 dhjetor 2010

praktikave të ndryshme<sup>101</sup>. Për më tepër, është në pikëpyetje nëse dispozitat për pushimin e lindjes janë aq me përfitim sa është menduar, kryesisht pasi duket se ato diskriminojnë burrat dhe gratë.

Sa i përket trafikimit të qenieve njerëzore, mund të raportohet disi progres pasi që shumë raste janë paraqitur në prokurori dhe në përgjithësi, Qeveria ka marrë një qasje shumë-kahëshe në këtë fushë. Mirëpo, nevojitet të bëhet më shumë sa i përket fëmijëve dhe sigurimit të parandalimit, identifikimit të viktimave dhe ndjekjes penale të trafikantëve të fëmijëve<sup>102</sup>.

#### Komuniteti LGBT

Edhe pse ekziston kornizë ligjore që ndalon diskriminimin në baza të orientimit seksual<sup>103</sup>, zbatimi dhe ekzekutimi i saj vazhdon të paraqet shqetësim – sidomos kur herë pas here në shtyp kanë mbizotëruar qëndrime negative që qytetarët LGBT i cilësojnë si 'të sëmurë mendorë'<sup>104</sup>. Gjithashtu, institucionet nuk i përmendin apo iu referohen këtyre personave, as me gojë, as me shkrim. Një shembull me rëndësi është Raporti i Dhjetë Vjetor i Ombudspersonit (2010), që mbulon një sërë të drejtash edhe de facto, edhe de jure, mirëpo jo vështirësitë e komunitetit LGBT. Është me rëndësi të madhe që kjo çështje të adresohet, me ç'rast institucionet duhet të marrin rol udhëheqës përmes debateve publike, trajnimeve dhe krijimit të një mjedisi ku qytetarët të mund të deklarojnë lirshëm orientimin e tyre seksual pa frikë hakmarrjeje dhe të gëzojnë të drejtat e tyre.

#### Personat e zhdukur

Ligji mbi Personat e Zhdukur<sup>105</sup> është miratuar, por është arritur pak progres. Ligji nuk adreson një sërë çështjesh të rëndësishme sikurse kompensimi për familjet e viktimave, privilegje të posaçme për të vejat dhe fëmijët e tyre dhe nuk ofron asnjë mekanizëm llogaridhënieje kur familjarët e viktimave përballen me vështirësi në ushtrimin e të drejtës së tyre për të ditur, ndërsa nuk adreson fare të drejtën për të vërtetën. Gjithashtu, ligji nuk njeh festën që tashmë përkujtohet: atë të Ditës së Personave të Zhdukur më 27 prill.

Sa i përket Komisionit për Personat e Zhdukur, ai vazhdon të përbëhet vetëm nga kosovarë-shqiptarë. Hetimet për varreza masive të pohuara në disa rajone të Kosovës kanë filluar, por po ecet përpara me ngadalësi. Mbi të gjitha, palët dhe institucionet përgjegjëse kritikohen për mungesë të progresit në këtë drejtim.

#### Drejhtësia tranzicionale

Në përputhje me Planin e Ahtisaarit, Qeveria e Kosovës është e detyruar që nga mekanizmat e saj për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të ofrojë edhe nisma për drejtësi tranzicionale<sup>106</sup>. Brenda kësaj sfere mund të raportohet progres deri diku me themelimin e Institutit për Hetimin e Krimeve të Luftës<sup>107</sup>. Megjithatë, Instituti ka filluar të marrë kritika me vend; sidomos sa i përket metodave jotransparente që janë përdorur për rekrutim, ku nuk është përfshirë publiku dhe palët relevante. Poashtu, nga perspektiva e nismës tashmë ekzistuese rajonale për komisionin rajonal KOMRA<sup>108</sup>, mbetet të shihet nëse ky Institut do të kontribuojë pozitivisht dhe të përmbushë mandatin e tij, aq më tepër që bashkëpunimi rajonal do të jetë tej mase i rëndësishëm.

101 Përmbledhje e Politikës nga GAP, 'Ligji i Punës: zbatimi i tij në gjashtë muajt e parë' qershor 2011, në f. 3-6, që gjendet në <http://www.institutigap.org/repository/docs/LabourLaw2.pdf> lexuar më 18/09/2011

102 Departamenti i Shtetit SHBA, 'Trafikimi i Personave Raporti 2011 – Kosovë', që gjendet në <http://www.state.gov/g/tip/rls/tiprpt/2011/164232.htm> lexuar më 18/09/2011

103 Neni 2 (a) Ligji Kundër Diskriminimit 2004

104 Departamenti i Shtetit SHBA, 'Raporti mbi të Drejtat e Njeriut 2010: Kosova', 8 prill 2011 që gjendet në <http://www.state.gov/g/drl/rls/hrrpt/2010/eur/154432.htm> lexuar më 18/09/2011

105 Ligji Nr. 04/L-023, miratuar më 31 gusht 2011

106 Neni 2 (5), Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës, 26 mars 2007, që gjendet në [http://www.unosek.org/docref/Comprehensive\\_proposal-english.pdf](http://www.unosek.org/docref/Comprehensive_proposal-english.pdf) lexuar më 21/09/2011

107 I themeluar më 1 qershor 2011 dhe do të funksionojë nën ombrellën e Ministrisë së Drejtësisë, që gjendet në <http://www.md-ks.org/?page=1,180> lexuar më 21/09/2011

108 Gjendet në <http://www.zarekom.org/The-COalition-for-RECOM.en.html> lexuar më 21/09/2011

### **Institucionet për të drejtat e njeriut**

#### Ombudspersoni

Ky është një institucion posaçërisht i rëndësishëm për zhvillimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë, edhe pse në këtë periudhë për të cilën raportohet nuk ka punuar me standardin e kërkuar ligjor<sup>109</sup>. Ka pasur një sërë arsyes për këtë, më kryesorja prej të cilave është politizimi. Kjo ka ndikuar që Ombudspersoni të mos e ngris zërin ndaj disa shkeljeve të të drejtave të njeriut, ka pasur një sërë ndryshimesh në staf dhe vazhdojnë përplasjet rreth emërimit të zëvendësve të tij. Për më tepër, institucione të tjera qeveritare kanë vazhduar të sfidojnë letrat dhe rekomandimet e bëra nga Ombudspersoni. Është absolutisht me rëndësi jetike që Ombudspersoni të jetë dikush i cili ka integritetin më të lartë dhe është i interesuar vetëm t'iu shërbejë njerëzve dhe të mbrojë të drejtat e tyre të njeriut. Duhet ndërmarrë urgjentisht të gjithë hapat e nevojshëm për t'i rikthyer Zyrës së Ombudspersonit rolin e saj të pavarur në mënyrë që ajo t'iu shërbejë njerëzve të Kosovës dhe të mbrojë të drejtat e tyre të njeriut<sup>110</sup>.

#### Njësitë për Drejtat e Njeriut (Ministritë/ Komunat)

Njësitë për të Drejtat e Njeriut vazhdojnë të jenë joefektive për shkak të

urdhëresave administrative jokoherente, mungesës së organizimit dhe koordinimit dhe kapaciteteve të ulëta për t'iu shërbyet qytetarëve të Kosovës. Ato rrallëherë i përdorin metodat që kanë për t'i informuar qytetarët se cili është roli i tyre – për shembull, shumica e faqeve të tyre në internet nuk kanë informacion të dobishëm apo të azhurnuar. Në përgjithësi, mekanizma të tillë nuk po e kryejnë punën si duhet dhe nuk po i kontribuojnë vetëdijesimit apo mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

<sup>109</sup> Neni 3, 'Ligji për Ombudspersonin', Ligji Nr.03/L – 195, miratuar më 09 gusht 2010

<sup>110</sup> Observim i Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë gjatë punës me projekte të ndryshme

### 3. PROGRESI EKONOMIK

#### 3.1 Sektori real

##### Pasqyrat makroekonomike

Përkundër progresit të lehtë transitor, ekonomia në Kosovë vazhdon të varet kryesisht nga burime të paqëndrueshme zhvillimore. Shpenzimet qeveritare, remitencat nga diaspora si dhe asistencë financiare ndërkombëtare vazhdojnë të jenë shtytësit kryesor të rritjes ekonomike. Madje këto të fundit përbëjnë rreth 20% të Bruto Produktit Vendor. Qytetarët kosovarë vazhdojnë të jenë më të varfrit në Evropë me një të ardhur për kokë banori prej vetëm 1800 euro (Riinvest 2011). Këto parametra të rënduar ekonomik inkurajojnë migrimin dhe ekonominë e zezë në vend që llogaritet të jetë rreth 1 miliard euro dhe me një evazion fiskal të pa grumbulluar nga mekanizmat mbledhës në vlerë prej 300-400 milion euro, vlerë kjo vjetore (Riinvest 2011).

Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), ekonomia e Kosovës në vitin 2010 shënoi rritje reale të Bruto Produktit Vendor (BPV) prej 4.6% në krahasim me vitin 2009<sup>111</sup>. Ishin shpenzimet qeveritare shtytësit kryesor të kësaj rritjeje që edhe gjatë vitit të fundit vazhdojnë të jenë forca motorike e zhvillimit ekonomik në Kosovë (FMN 2011), të pasuara nga remitencat nga diaspora që shënuan një rritje të lehtë fatë rikuperimit të ekonomisë globale.<sup>112</sup> Sipas parashikimeve të FMN-së, BPV-ja pritet të shënojë rritje në vitin 2010 dhe 2011 me 5.5% respektivisht 5.2%. Sipas planit qeveritar kjo rritje duhet të gjenerohet kryesisht nga sektori privat, megjithatë të dhënat e para nga BQK tregojnë për një hiperprezencë të shpenzimeve qeveritare në strukturën e kontribuuesve ekonomik në vend. Pavarësisht kësaj, rritja prej 5.1%, ndonëse pozitive, vazhdon të mbetet prapa nevojave zhvillimore të Kosovës.

111 Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) 2011, IMF Executive Board Concludes 2011 Article IV Consultation with the Republic of Kosovo, <http://www.imf.org/external/np/sec/pn/2011/pn11105.htm>

112 Banka Qendrore e Kosovës (BQK) 2011, Raporti vjetor 2010, <http://bqk-kos.org/repository/docs/2011/Raporti%20Vjetor%202010.PDF>

Rritja e planifikuar nuk mjafton për adresimin e problemeve socio-ekonomike të Kosovës. Sipas Bankës Botërore (2011) Kosova ka nevojë për një rritje vjetore prej 8-10% për të ulur nivelin e rëndë të papunësisë dhe varfërisë si dhe për të gjeneruar zhvillim ekonomik të qëndrueshëm.<sup>113</sup>

##### Tregu i punës

Kosova vazhdon të ketë papunësinë më të madhe në Evropë. Sipas UNDP-së (2011), në vitin 2010 papunësia në Kosovë ka qenë 44.3%. Pjesën më të madhe të kësaj përqindje e përbëjnë femrat dhe të rinjtë me 59.6% respektivisht 73%.<sup>114</sup> Sipas Bankës Qendrore (2011) numri i punëkërkuësve në vitin 2010 ka pësuar rënie prej 1.1 % në krahasim me vitin e kaluar. Këtë strukturë e dominojnë punëkërkuësit e pakualifikuar me 63.4%, të pasuar nga ata me shkollë të mesme 34.6% dhe ata me diploma universiteti me 1.8%<sup>115</sup>. Në përgjithësi, punësimi në sektorin privat ka shënuar rritje të ndjeshme prej 14 pikë përqindje (pp) në vitin 2010 krahasuar me vitin paraprak, përderisa sektori publik ka pësuar rënie të theksuar prej 14 pp në të njëjtën periudhë.<sup>116</sup>

Papunësia e rëndë vazhdon të mbetet shqetësim serioz i rimëkëmbjes së Kosovës. Pjesa më e madhe e të papunëve janë të pakualifikuar dhe të paafësuar për punë; për më tepër qëndrimi i tyre për një kohë të gjatë jashtë tregut të punës ka rënduar më shumë mundësinë e angazhimit të kësaj force punëtore. Për më tepër, në Kosovë vazhdojnë të hynë në treg të punës rreth 24 mijë të rinj në baza vjetore duke bërë kështu ritmin e tanishëm të krijimit të vendeve të punës të padukshëm.<sup>117</sup>

Stagnimi në punësim përkundër një rritjeje ekonomike është tregues i një

113 FES-Riinvest 2011, Forumi mbi politikën ekonomike, [http://www.fes-prishtina.org/wb/media/FESRIINVESTALBANIAN\(fin\).pdf](http://www.fes-prishtina.org/wb/media/FESRIINVESTALBANIAN(fin).pdf)

114 United Nations Development Program (UNDP) 2011, [http://www.kosovo.undp.org/repository/docs/MDG\\_1.pdf](http://www.kosovo.undp.org/repository/docs/MDG_1.pdf)

115 Ibid 112.

116 Ministria e Punës dhe Mirëqenjes Sociale (MPMS) 2011, Puna dhe Punësimi, <http://mpms.rks-gov.net/Portals/0/Librat/AL%202010%20Raporti%20Vjetor.pdf>

117 Ibid 112

shpërndarje të pabarabartë të zhvillimit ekonomik të Kosovës nga krijimi i vlerës së re.

#### Inflacioni

Sipas Bankës Botërore (2011), Indeksi i Çmimit të Konsumatorit (IÇK) në vitin 2010 ka pësuar një rritje mesatare vjetore prej 3.5%. Në anën tjetër, Enti Statistikor deklaroi që IÇK në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2011 ka pasur një rritje prej 10.7% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2010. Ka disa arsye prapa një rritjeje të lartë inflacioniste. Së pari, një pjesë e madhe e çmimeve janë në varësi të plotë nga importi i Kosovës. Së dyti, një sërë politikash fiskale drejt produkteve bazike (nafta dhe derivatet tjera) kanë shkaktuar rritjen e pjesshme të çmimeve. Së treti, rritja e çmimeve në muajt e fundit ka ndodhur pjesërisht si pasojë e rritjes së pagave në sektorin publik dhe reflektimin e bizneseve ndaj pritjeve. FMN parasheh që mesatarja e rritjes së çmimeve për vitin 2011 të jetë 8.3%. Një rritje e tillë prek më së rëndi shtresat e të papunëve dhe të varfërve, fuqia blerëse e të cilëve vazhdon të goditet rëndë në terma real.

Inflacioni në parametra si këto rëndon dukshëm kualitetin e jetës së kosovarëve me theks të veçantë të familjeve me të ardhura nën-mesatare dhe atyre në varfëri.

### **3.2 Sektori Fiskal**

#### Të hyrat dhe shpenzimet buxhetore

Parametrat e qëndrueshmërisë buxhetore në Kosovë kanë shënuar luhajtje nga viti në vit, me një tendencë të suficiteve gjatë viteve të para dhe deficiteve në rritje në vitet e fundit. Deri sa suficitet e para krijoheshin nga mos-afërsia planifikuese e projeksioneve buxhetore, kufizimet e ligjit mbi prokurimin publik, dhe ngecja në shpenzimet buxhetore, deficitet e fundit janë krijuar si rezultat i hiper-shpenzimeve. Ky kalim nga teprica e parasë publike në mungesë është tregues se Kosova po shpenzon më tepër se që gjeneron duke krijuar kështu hendeqe buxhetore të cilat mund të financohen nga bilancet bankare

apo të hyrat e njëhershme.

Të hyrat buxhetore në vitin 2010 kanë shënuar rritje prej 2.8% krahasuar me vitin paraprak.<sup>118</sup> Në anën tjetër, shpenzimet buxhetore në vitin 2010 janë rritur për 3.2% në krahasim me vitin 2009. Edhe në vitin 2010 investimet kapitale përbëjnë pjesën më të madhe të shpenzimeve. Në krahasim me vitin 2009, në vitin 2010 shpenzimet kapitale kanë shënuar rritje për 13.7%.<sup>119</sup>

Deficiti i përgjithshëm buxhetor për vitin 2011 pritet të jetë 226 milion euro apo rreth 5% e Bruto Produktit Vendor. Kjo normë konsiderohet të jetë relativisht e madhe sipas FMN. Poashtu, kjo i tejkalon normat e rekomanduara të deficitit buxhetor në Bashkimin Evropian që nuk e kalojnë 3.5% si dhe marrëveshjen me FMN. Deri me tani, viti 2011 është vit rekord sa i përket investimeve kapitale. Pjesë të madhe në këtë shportë merr autostrada "Ibrahim Rugova". Sipas projektit fillestar të nisur në vitin 2009, rruga duhej të kalonte përmes tetë komunave dhe të mbulonte rreth 1,062 hektar tokë. Qeveria ka argumentuar se Kosova do të përfitojë nga projekti për shkak se do të hapen korridore Evropiane, dhe njëkohësisht do të krijohen vende pune. Projekti më i madh kapital në vend pritet të përfundohej brenda tri viteve.

Mirëpo, i gjithë procesi nuk ka kaluar pa probleme. Për të zvogëluar koston dhe evituar terrenet e vështira malore, Qeveria e Kosovës me 27 Prill 2011 mori vendim të ndryshojë trasenë e rrugës. Ky ndryshim i trasës do të reflektojë mbi koston totale të autostradës, vlera e së cilës nuk dihet, ngase studimet e fizibilitetit që do të përcaktonin koston e dhe përfitimet e projektit nuk janë publikuar. Kostoja totale që pritet t'i kushtojë Kosovës për këtë projekt është rreth 700 milion Euro (Vlerësim i dhënë nga Kryeministri i Kosovës). Megjithatë projeksioni zyrtar i shpenzimeve nuk është publikuar nga Qeveria e Kosovës. Mosaktimi i çmimit fiks të autostradës ka ndikuar që kostoja e projektit të mund të rritet deri në

<sup>118</sup> Ibit 113.

<sup>119</sup> Ibit 112.

shifra të papërballueshme. Ngarkesat e papërballueshme për buxhetin e Kosovës, si dhe tejkalimi i kostove mbi planifikimet fillestare, duket të kenë shtyrë Qeverinë e Kosovës që të analizojë trasetë alternative të autostradës të cilat do të kenë një kosto më të ulët. Projekti vazhdon të shoqërohet me defekte në transparencë, meqë 16 muaj pas inicimit të tij, ende nuk është zgjedhur autoriteti mbikëqyrës i kryerjes së punëve. Mospublikimi i kontratës së autostradës ka ngritë debat të gjerë dhe dyshim për keqpërdorime në këtë drejtim. Autostrada "Ibrahim Rugova" pritet të financohet nga Buxheti i Kosovës. Të hyrat për financim do të gjenerohen edhe nga shitja e PTK-së. Derisa mosçaktimi i çmimit të autostradës mund të ndikojë në rritjen e kostos totale, implikimet në investimet tjera kapitale janë madhore. Kosova, të paktën për dy vitet e ardhme do të ketë restriksione serioze në ndërtimin e rrugëve regjionale dhe në investimet tjera kapitale.

Shqetësues mbetet disbalanci buxhetor i cili në katër vitet e fundit ka kaluar nga një suficit prej 7.2% të BPV-së në deficit prej 5.1% të BPV-së, duke sinjalizuar kështu nevojën imediate për reduktime buxhetore me qëllim të stabilitetit financiar në vend. Trendi i disbalancit financiar tregon se Kosova ka shpenzuar dhe vazhdon të shpenzojë më tepër se që gjeneron të hyra.

#### Marrëveshja me Fondin Monetarë Ndërkombëtar

Në vitin 2010, të shtyrë nga disiplinimi buxhetor, qeveria e Kosovës ka nënshkruar një marrëveshje ndërkombëtare me FMN-në të njohur si "Stand-By Agreement". Nga kjo marrëveshje, realizimi i së cilës kërkonte një disiplinim buxhetor, vlen të theksohen 3 elemente kyçe: a) pagat në sektorin publik nuk guxojnë të kalojnë 7.4% të GDP-së, ose 290 milion euro; b) shitja e PTK-së duhet të gjenerojë 300 milion euro për të mbuluar deficitin; dhe c) deficitin buxhetor duhet të mbahet brenda kornizave të BE-së.<sup>120</sup> Derisa deficitin buxhetor për vitin 2010-të është

mbajtur brenda këtyre kornizave, fillimi i 2011 ka shënuar shpenzime shtesë të cilat kanë tejkaluar kornizat e marrëveshjes paraprake. Rritja e pagave në 378 milion euro ka tejkaluar kufizimet e FMN-së për 35%, përkundër një rritjeje të GDP-së prej vetëm 4.6%. Rritja e tillë ka qenë shkelje e njëanshme e një marrëveshjeje të rëndësishme financiare që për garanci ka pasur 110 milion euro ndihma financiare nga FMN.

Shkelja e marrëveshjes ka ngritë nevojën për një ridizajnim të relacionit në mes të FMN-së dhe Kosovës. Nga Korriku 2011, FMN kalon Kosovën nga "Stand By Arrangement" në "Staff Monitored Program" apo nga një marrëveshje formale përfituese në një program joformal e monitorues, duke i restriktuar kështu asistencën financiare Kosovës.

Ridizajnimi i marrëveshjes me FMN-në nga një relacion përfitues kontraktual në një relacion jo-përfitues e jo-formal për Kosovën është ecje mbrapa në të gjitha proceset integruese, në qëndrueshmërinë makro-fiskale dhe në tërheqjen e investitorëve potencial. Ish marrëveshja me Fondin Monetar Ndërkombëtar, sipas buxhetit të viti 2011, paraqet burimin thelbësor të financimit të deficitit. Ky ridizajnim i saj rrezikon tëlë deficitin e Kosovës të pambuluar për vitin 2011, duke shtyrë kështu nevojën e përdorimit të bilancit bankar të grumbulluar nëpër vite dhe të hyrave të njëhershme nga shitja e asetëve nacionale. Relacioni me FMN-në është regresi më i madh ekonomik në Kosovë për vitin 2011.

### **3.3 Sektori Financiar**

Në vitin 2010, sektori financiar në Kosovë, ka shënuar rritje me të ngadalshme krahasuar me vitin 2009. Pjesën më të madhe të asetëve të sektorit financiar vazhdojnë ta përbëjnë bankat komerciale me rreth 77 %.<sup>121</sup>

<sup>120</sup> Forumi 2015 (2011), Shteti dhe Buxheti

<sup>121</sup> Ibit 112.

### Sektori i bankave komerciale

Sipas raportit të Bankës Qendrore, struktura e sistemit bankar të Kosovës në vitin 2010 ka mbetur e njëjtë krahasuar me vitin paraprak si për nga numri i bankave po ashtu edhe për nga struktura e pronësisë. Vlera e asetëve të citat i menaxhojnë bankat komerciale në Kosovë është 2.5 miliardë euro. Shikuar në terma relativë asetet në sektorin bankar në vitin 2010 kanë shënuar një rritje prej 10.5 pikë përqindjeje krahasuar me vitin 2009. Aktiviteti kryesor i sistemit bankar vazhdon të jetë kreditimi, i cili në vitin 2010 ka shënuar një rritje prej 4.3 pikë përqindjeje krahasuar me vitin 2009. Vlera e kredive të lëshuara nga bankat komerciale në vitin 2010 ka arritur në 1.46 miliard euro (BQK 2011). Sa i përket strukturës së kredive, prijnë ndërmarrjet me një pjesëmarrje 70.5 %, pasuar nga ekonomitë familjare me 29.5 %, ku dominojnë kreditë me afat të gjatë maturimi.

Burim kryesor i financimit të bankave komerciale në Kosovë janë depozitat e mbledhura brenda Kosovës. Trendi i rritjes së këtyre depozitave ka qenë rreth dy herë më i vogël në vitin 2010, respektivisht 9.8 pikë përqindjeje më i vogël krahasuar me vitin 2009.<sup>122</sup> Megjithatë, ky fakt shpjegohet me tërheqjen e depozitave të qeverisë nga bankat komerciale. Vlera e përgjithshme e depozitave në dhjetor të vitit 2010 ka arritur në 1.93 miliard euro. Sa i përket strukturës së depozitave, prijnë ekonomitë familjare me gjithsej 1.3 miliard euro të depozituara (67.1%) të depozitave të përgjithshme, të pasuara nga ndërmarrjet me 526.6 milion euro (27.2 %). Depozitat karakterizohen me një afat të shkurtër maturimi. Profiti i këtyre bankave në vitin 2010 arrijnë në 32.8 milion euro, respektivisht 29.9 % më i lartë se në vitin e kaluar.

Qëndrueshmëria e sektorit bankar është inkurajuese marrë krizat ekonomike dhe financiare në Evropë. Një qëndrueshmëri e tillë shënon progres financiar në Kosovë. Megjithatë, normat e larta të interesit të ofruara nga ky sektor për bizneset kosovare

kanë vazhduar të jenë barrierë serioze në zhvillimin e sektorit privat.

### Normat e interesit

“Rreziku kreditor në Kosovë vazhdon të perceptohet me norma më të larta të interesit krahasuar me vendet e rajonit. Kosova ngecë në fuqizimin e konkurrencës në tregun e saj bankar. Faktorët që ndikojnë në këtë janë efikasiteti i sistemit gjyqësor dhe gjendja e sistemit kadastral në njërën anë si dhe kapacitetet dhe serioziteti i ndërmarrjeve në përmbushjen e kushteve themelore për marrjen e kredive nga ana tjetër.”

Në vitin 2010, norma mesatare e interesit për kreditë në Kosovë ka shënuar një rritje të lehtë krahasuar me vitin 2009 (nga 14.4 % sa ishin në vitin 2009 në 14.6 % në 2010). Kjo normë vazhdon të jetë më e larta në rajon (Shqipëri – 12.9 %, Maqedoni – 11.9, Serbi – 10.29 %, Kroaci – 10.18). Rritja e normave të interesit ka prekur proporcionalisht të gjithë sektorët, me theks të veçantë atë të bujqësisë. Bankat komerciale kanë rritur normat e interesit për kredi personale nga 10.8 % në 12 %, për kredi biznesi nga 12% në 15.6 %, ndërsa për agro-kredi nga 15 % në 24 %<sup>123</sup>. Bankat komerciale në Kosovë vazhdojnë të kenë një profit relativisht të lartë.

Normat e larta të interesit vazhdojnë të jenë barrierë serioze në gjenerimin e kapitalit në Kosovë.

### **3.4 Sektori i jashtëm**

#### Eksportet dhe Importet

Kosova vazhdon të ketë probleme serioze me deficitin tregtar. Eksportet vazhdojnë të jenë simbolike përball importeve të larta. Ky deficit është rritur nga 1.77 milion euro sa ishte në vitin 2009 në 1.85 milion në vitin 2010, dhe vazhdon të ketë trend të njëjtë rritës edhe për vitin 2011. Në terma relativ rritja vjetore e deficitit tregtar është 4.6%. Pjesëmarrja e deficitit tregtar në BPV në vitin 2010 ka pësuar rënie të lehtë nga 45.8 %

<sup>122</sup> Ibit 112.

<sup>123</sup> Revista per Ekonomi dhe Biznes 2011.



sa ishte në 2009 në 45.0 %. Bazuar në raportin e Bankës Qendrore, rritja vjetore e çmimeve të derivateve të naftës në tregjet ndërkombëtare prej 25% ka ndikuar në rritjen e produkteve të importuara. Edhe pse ka pasur një rritje relativisht të lartë të eksporteve në raportin eksport/import, të cilat janë rritur nga një bazë shumë e ulët por duket të jetë larg nga korigjimi i jobalanceve tregtarë ekonomik. Niveli (i ulët) dhe struktura e tregtisë së jashtme duket se tregon konkurrencë të ulët të produkteve kosovare edhe në tregun e brendshëm dhe atë të jashtëm.

Një disbalanc i tillë tregtar në rritje vazhdon të jetë shqetësues për Kosovën. Mosaftësia e zëvendësimit të importit me produkte vendore ka ndikuar mjaft në rritjen e hendekut.

#### Marrëveshja rajonale e tregtisë së lirë (CEFTA)

Eksporti në vendet e CEFTA-s në vitin 2010 ka pësuar rënie krahasuar me atë të vitit të kaluar. Në vitin 2009, 32.4% të eksportit të përgjithshëm të Kosovës është realizuar në vendet anëtare të CEFTA-s, ndërsa në vitin 2010 këto eksporte kanë rënë në 24.1%.<sup>124</sup> Vendet e CEFTA-s në të cilat Kosova ka eksportuar më së shumti në vitin 2010 kanë qenë Shqipëria dhe Maqedonia me 11% respektivisht 8.9%. Në anën tjetër, në vitin 2010, importi nga këto vende vetëm sa është rritur në krahasim me vitin 2009. Sipas Doganave të Kosovës (2011), Kosova në vitin 2010 krahasuar me vitin 2009 ka importuar rreth 22% më shumë nga Serbia dhe rreth 39% më shumë nga Bosnia dhe Hercegovina.<sup>125</sup> Trendi i njëjtë ka vazhduar edhe në gjashtëmujorin e parë të vitit 2011.

Në muajin korrik të vitit 2011 Kosova ka vendosur t'i aplikoj masat e reciprocitetit karshi Serbisë dhe Bosnje Hercegovinës. Për të parën herë, qeveria e Kosovës vendosi që t'ia ndalojë importin e të gjitha produkteve, ndërsa për të dytën vendosi që të aplikojë

një taksë doganore prej 10%. Vënia e masave të reciprocitetit nuk reflektoi me ndonjë çrregullim ekonomik në Kosovë. Përkundrazi, Kosova arriti të zëvendësojë produktet serbe me ato të vendeve fqinje.

Ndonëse mbyllja tregtare nuk është në frymën e integriteteve evropiane, zgjidhja e problemit kërkon kompromis të dyanshëm.

#### Masat tregtare preferenciale të BE-së

Me përmirësimin e tregjeve në Bashkimin Evropian në vitin 2010 u rriten edhe eksportet Kosovës në vendet e këtij unioni. Sipas raportit të Bankës Qendrore, në 2010 eksporti i produkteve në vendet e Bashkimit Evropian është rritur në 44.7% krahasuar me 43.1 në vitin 2008. Megjithatë, nga fillimi i vitit 2011, Kosova mbetet vendi i vetëm në rajon pa preferenca tregtare me BE-në.

Heqja e preferencave tregtare për Kosovën nga BE-ja ka qenë një goditje e rëndë ekonomike për eksportet simbolike të Kosovës.

### **3.5 Ambienti biznesor**

Kosova në vitin 2011 është renditur e 119-ta nga gjithsej 183 ekonomi të cilat krahasohen çdo vit në analizën krahasuese të Bankës Botërore "Doing Business". Këtë vit Kosova humbë 6 vende, krahasuar me raportin e vitit 2010-të.

Sektori privat në Kosovë vazhdon të vuaj nga mungesa e sundimit të ligjit, mungesa e furnizimit cilësor me energji elektrike, infrastruktura e dobët dhe nga qasja e limituar në financim.

Vetëm 3% e bizneseve kosovare (Banka Botërore 2011) u janë drejtuar gjykatave gjatë vitit të kaluar. Ky fakt tregon për prezencën e një ambienti të rëndë gjyqësor dhe mungesës së besimit të bizneseve ndaj këtij sistemi. Furnizimi i parregullt me energji elektrike vazhdon të pengojë prodhuesit vendor në mbarëvajtjen e rregullt të procesit të prodhimit. Humbjet nga ndërprerjet si dhe kostot shtesë të furnizimit të rregullt nëpërmjet burimeve alternative janë rëndesë serioze për bizneset kosovare. Infrastruktura dhe shërbimet publike në

<sup>124</sup> Ibid 112.

<sup>125</sup> Doganat e Kosoves (2011), Raporti vjetor 2010, [http://dogana.rks-gov.net/Uploads/Documents/Raporti\\_Vjetor\\_2010.pdf](http://dogana.rks-gov.net/Uploads/Documents/Raporti_Vjetor_2010.pdf)

anën tjetër vazhdojnë të jenë inferiore përballë nevojave të bizneseve kosovare.

Ligji i punës i vendosur gjatë vitit 2011 ka hasur në refuzime të shumta nga sektori privat, me theks të veçantë në pushimet me pagesë dhe pagën minimale. Çështjet si këto janë adresuar në Këshillin ekonomiko-social. Me theks të veçantë pushimi i zgjatur lindjes ka reflektuar të rëndojë edhe më shumë pozitën ekonomike të femrave, duke i shtyrë bizneset të jenë më selektiv në punësimin e gjinisë femërore.

Ambienti biznesor në Kosovë vazhdon të shënoj mungesë përparimi. Rangimet biznesore kanë shënuar regres.

### **3.6 Privatizimi i Ndërmarrjeve Publike**

Qeveria e Kosovës ishte shumë aktive në procedimin e privatizimit të kompanisë së telekomit (PTK). Startimi i këtij procesi privatizues është paraprirë nga një mbipunësim i rëndë në PTK pa ndjekur procedurat bazike të rekrutimit dhe caktimi i anëtarëve të bordit të cilët ishin politikisht të influencuar, janë veprime të cilat kanë përkeqësuar gjendjen e kësaj ndërmarrjeje. Pasi PTK është një kompani fitimprurëse, argumentet e qeverisë për privatizimin kanë dështuar për të arritur koncensus në parlament dhe në publikun e gjerë se benefitet prej privatizimit të PTK-së janë më të mëdha se sa mbajtja në pronësi publike. Për më tepër, projektet

e kontraktuara infrastrukturore nxisin nevojën për privatizimin e PTK-së për të përmbushur shpenzimet e projekteve dhe për të ruajtur qëndrueshmërinë fiskale. Privatizimi i PTK-së është pjesë e marrëveshjes në mes të Kosovës dhe FMN-së. Të ardhurat nga privatizimi, si financim pa-borxh, duhet të sigurojnë se Kosova mund të shmang huamarrjet komerciale për të përmbushur shpenzimet e lindura nga investimet kapitale të kontraktuara. Strategjia e privatizimit të PTK-së, e cila është ballafaquar me shumë opozitë në parlament, ka paraparë shitjen e 75% të aksioneve të kompanisë. Gjatë vitit të fundit ky proces është ngadalësuar përderisa menaxhmenti i kësaj ndërmarrjeje është nën hetime të prokurorisë për operim në dëm të ndërmarrjes. Vonesa ka pasur edhe në procesin e privatizimit në sektorin e energjisë. Ky proces nuk është bërë pjesë e diskutimit publik dhe është përcjellur me mungesë transparence.





#### Iniciativa për Progres - INPO

"INPO është organizatë e themeluar në vitin 2005 me qëllim të promovimit të politikave publike efikase, transparente dhe llogaridhënese në qeverisjen lokale, me synimin përfundimtar integrimin e qytetarëve dhe të rinjëve në proceset vendimmarrëse dhe proceset demokratike. Për të përmbushur këtë mision INPO funksionon në saxe të tri programeve: Programi për Qeverisje të Mirë, Indeksi i Qeverisjes Lokale dhe Shkolla e Aktivizimit (Activa). <http://inpo-ks.org/>



#### Instituti Demokratik i Kosovës - KDI

KDI është organizatë jo qeveritare vendore e cila ka mision që të mbështesë zhvillimin e demokracisë duke fuqizuar qytetarët dhe sektorin joqeveritar për të ndikuar në rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së institucioneve qeveritare dhe përmirësimit të efikasitetit të këtyre institucioneve përmes pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje. KDI synon të jetë një organizatë rajonale me ndikim në proceset politike përmes ofrimit të asistencës në procesin e demokratizimit. <http://www.kdi-kosova.org>



#### Instituti për Hulumtime Zhvillimore - Riinvest

Riinvest operon që nga viti 1995 si organizatë hulumtuuese, private

joprofitabile, me mision që ta promovoj zhvillimin modern ekonomik të Kosovës bazuar në filozofinë e ndërmarrësisë. Aktivitetet e Riinvestit gjatë viteve kanë përfshi organizimin e seminareve, uorkshopeve, analizimit të situatave në sektorë të ndryshëm dhe drejt një rikonstruktimit të suksesshëm. Që nga viti 2001 aktivitetet kryesore përfshijnë hulumtimet mbi politikën dhe advokime për rritjen e mjedisit të biznesit dhe krijimit të kushteve për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. <http://www.riinvestinstitute.org/>



#### Klubi për Politikë

##### të Jashtme - KPJ

Klubi për Politikë të Jashtme është organizatë joqeveritare e cila mbledh rreth vetes intelektualë, politikanë dhe aktivistë të shquar të shoqërisë civile, që tregojnë afinitet në politikë të jashtme. Klubi ka për qëllim që përmes një debati intelektual të kontribuojë përmes rekomandimeve në gjenerimin e politikave të jashtme të Kosovës, në funksion të paqes ne Kosove, rajon dhe botë. <http://foreignpolicyclub.org/>



#### Lëvizja FOL

Organizata është themeluar të mbështes qytetarinë aktive, të rris transparencën dhe llogaridhënien, për të kontribuar në qeverisje të mirë dhe parandalim të korrupsionit në institucionet publike. Organizata ndërmerr aktivitetet si: debate dhe trajnime, konferenca, seminare dhe tryeza, publikime dhe hulumtime, monitorimin e institucioneve publike si dhe mobilizim dhe rrjetëzim. Shpenzimi i fondeve publike, konflikti i interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale si dhe qasja në

informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL. <http://levizjafol.org/>



#### Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë - QKSS

QKSS është think-tank lokal e themeluar në vitin 2008 me qëllim të promovimit dhe forcimit të demokratizimit në sektorin e sigurisë në Kosovë dhe rajon. Objektivë kryesorë e QKSS-së është të kontribuoj në nxitjen e mbikëqyrjes demokratike të institucioneve të sigurisë, si dhe të rrisë ndërveprimin mes shoqërisë civile dhe institucioneve publike në sektorin e sigurisë, drejtësisë dhe sundimit të ligjit. QKSS përmes komponentës së hulumtimeve synon gjithashtu të shërbejë si ekspertizë alternative në bërjen e politikave publike. <http://qkss.org>



YOUTH INITIATIVE FOR HUMAN RIGHTS  
NISMA E TË RINJVE PËR TË DREJTAT E NJERIU  
INICIJATIVA MLADIH ZA LJUDSKA PRAVA

#### Nisma e të rinjve për të drejtat e njeriut - YIHR

Nisma është rrjet rajonal i organizatave Jo-qeveritare që ka për qëllim ngritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në demokratizimin e shoqërisë dhe fuqizimit të sundimit të ligjit përmes procesit të ballafaqimit me të kaluarën dhe krijimin e lidhjeve të reja progresive në rajonin post-konfliktual të ish-Jugosllavisë. Nisma promovon të vërtetën, drejtësinë, përgjegjësinë dhe barazisë si vlera themelore. <http://ks.yihr.org/ks>

**Impressum**

**Editor:** Friedrich-Ebert-Stiftung

Rr.Mujo Ulqinaku 4/App 10

**Tel:** +381 38 609 900, 609 901

**Fax:** +381 38 609 902

**Email:** [contact@fes-prishtina.org](mailto:contact@fes-prishtina.org)

[www.fes-prishtina.org](http://www.fes-prishtina.org)

**Printing and Production:**

Trembelat

**Cover Design:** Trembelat

**Date of printing:** October 2011

**Location of Printing:** Prishtina

Copyright Friedrich-Ebert-Stiftung

